



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12/060-32943 dt. 17/08/ 2020

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Komunës së Drenasit z. Labinot Halilaj, me dt: 24.08.2020 (e Hënë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 24.07.2020.
2. Raporti i punës së Kryetarit Janar –Qershor 2020.
3. Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Glogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik /juridik.
4. Të ndryshme.

Drenas, 17. 08 .2020

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj





Republika e Kosovë
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. - 060/n1 - 32229 dt. 14/08/2020

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 24.07.2020, ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Komunës Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublatku, Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani, Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit Flutura Avdiu.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 22.06.2020.
2. Propozim Vendim për shpalljen e Lokalitetit të Boshtres (FORSYTHIA EUROPEA) në zonën e Goleshit- Fshatin Sankoc në Kategorinë- Monument i Natyrës, (e plotësuar).
3. Propozim Vendim për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Gllogocit 2020-2028, (e plotësuar).
4. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit
5. Propozim Vendim për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale në Komunën e Drenasit .
6. Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.12-353-22880, të datës 29.06.2020 për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe në zonën kadastrave në Zabel i Epërm.
7. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrave në Baicë.
8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020.

9. Propozim Vendim për caktimin e Lokacioneve për ndërtimin modernizimin dhe kompletimin e infrastrukturës përcjellëse të studionit të qytetit "Rexhep Rexhepi" në Poklek të Ri.
10. Propozim Vendim për caktimin e Lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e Çerdhes në Komoran.
11. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm Publik për kthimin e pronave të cilat janë nën menaxhimin e AKP-së, në zonat Kadastrale : Qikatovë e Re, Terstenik, Poklek , Korroticë e Poshtme, Zabel i Poshtëm, Komoran dhe Sankoc.
12. Raporti Financiar i Zhvillimit të Buxhetit Janar Qershor 2020.
13. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj-hapi mbledhjen e KPF-ca, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës, i njoftoi anëtarët e KPF-ca se kemi edhe një pika shtesë për rendin e ditës: 1.Raporti Financiar i Zhvillimit të Buxhetit Janar Qershor 2020.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-unë besoi që sot ose të hënën na vjen ligjshmëria për parcelizimin e pronave që i kemi pas dhe ne vetëm e dërgojmë në kuvend për me miratua për me bërë shpalljen për pronat që kemi me i dhënë me qira.

Burim Bujupi-para se me kalu të pikat e rendit të ditës,ditën që isha me marr materialin raporti financiar që e kemi sot nuk e kemi pas mirëpo kërkova nga sekretaria me ma dërgua ne imell private,nëse ka mundësi me ja leju për me na dërgu edhe ne imella private kur nuk na bënë imella zyrtare.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hodhi në votim rendin e ditës së bashku me një pikë shtesë, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtarë:

Për votuan 5 anëtar

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 22.06.2020.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi i Kuvendit Labinot Halilaj - hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 6 anëtarë: kjo pikë e rendit të ditës u votua në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën dytë të rendit të ditës: 2. Propozim Vendim për shpalljen e Lokalitetit të Boshtres (FORSYTHIA EUROPEA) në zonën e Goleshit- Fshatin Sankoc në Kategorinë- Monument i Natyrës, (e plotësuar).

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci -vetëm desha me cek që këtu janë dy ose tri pika për disa defekte te vogla që ne kemi me i rregulla dhe me i dërgua edhe një here në Kuvend.

ashtu edhe neni 3 të përcaktohet në bazë të ligjit mbrojtje të natyrës regjimi mbrojtës me parametra, diçka tjetër nuk ka pasur. Sa i përket Planit Zhvillimor Komunal pas vlershmit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit ka kërkuar që në nenin tre të ceket që plani zhvillimor komunal i Glllogocit të ceket se është hartuar nga drejtoria përkatëse për planifikim urban dhe mbrojtje të mjedisit në koordinim me drejtorit sektoriale dhe burimet njerëzore brenda Komunës për arsyes se në vendimin paraprak ka qenë e cekur që kompania do me thënë GIZI Gjerman dhe kompania hartues dhe kane vlerësuar që nuk është në harmoni me ligjin për planifikim hapësinor nga se ligji përcakton vetëm organin institucionin dhe koordinimin me drejtorit sektoriale këto kanë qene për këto arsye i kemi plotësua dhe shpresoj që të na kthehet konfirmimi i ligjshmërisë

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, me plotësime, ndryshime prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar:

Për votuan 6 anëtar.

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën e 4. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit

Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-Të ndëruar anëtarë të Komitetit të Komunës së Drenasit. Duke pasur për bazë Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, respektivisht nenin 23 paragrafin 1 dhe 2, ju njoftoj si në vijim:

Komuna e Drenasit gjatë viteve paraprake ka lidhur disa kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cilave kontrata ju ka skaduar afati i shfrytëzimit, andaj ashtu siç me obligon legjislacioni në fuqi po ju njoftoj me atë pronë:

Kontrata e lidhur me datë 25/03/2009, me nr .955-1922, me sipërfaqe 0.20.00 ha, e cila është pjesë e ngastrës nr. 244/4, në Zonën Kadastrale në Komoran, ka skaduar me datë 25.03.2019, ku shfrytëzues i përkohshëm (10 vite) ka qenë Kastriot Xheladin Gashi nga Komorani. Duke mos pasur asnjë mundësi të vazhdimit të tyre, sepse një gjë të tillë e ndalon neni 23 paragrafi 1 i Ligjit Nr .06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i cili thotë: Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës, në këtë formë duke mos lejuar asnjë vazhdim të asnjë kontrate, pa marr parasysh investimet e bëra nga personat që e kanë pasur në shfrytëzim pronën e paluajtshme komunale. Andaj, prona e lartcekur, edhe në bazë të listës së veçantë, ashtu siç e parasheh neni 13 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nuk është paraparë që të ipet në shfrytëzim për këtë vit, po ashtu kjo parcelë do të vlerësohet nga ana e Komunës së Drenasit, se e njëjta a do të ipet në shfrytëzim apo do të shfrytëzohet për interesat e Komunës së Drenasit, gjithnjë në përputhje me planin zhvillimor ekonomik të Komunës sonë. Ju faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën e 5 të rendit të ditës 5. Propozim Vendim për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale në Komunën e Drenasit .

Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-Propozim Vendim për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale në Komunën e Drenasit. Duke pasur parasysh nevojat e mëdha dhe kërkesat për mire mbajtjen dhe renovimin e rrethojave të varrezave në Komunën e Drenasit, Drejtoria e Shërbimeve, Publike dhe Emergjencë me kërkesën nr.13-942/06-23603 të datës 02.07.2020 I është drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë për definimin dhe parcelizimin e parcelave ku janë të vendosura varrezat, në pronat komunale. Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, pas miratimit të këtij propozim – vendimit është e gatshme që të bëjë të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale dhe pronësore.

Burim Bujupi-ky është një propozim I mirë që ka ardh ka pas edhe kërkesa prej banore se kanë pas dëshirë me bërë këtë punë edhe me herët parcelizimin e të gjitha pronave, varrezave me dit definitivisht kujt mbet kufijtë a ka pas kërkesa të tjera edhe çka ndodhe më varrezat që nuk janë prona komunale por janë prona private dhe a duhet komuna me ndërmarr ndonjë hap për me I kthyer në prona shoqërore me këmbim ose diçka tjetër

Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani- procedurat e këmbimit janë procedura tjera,po ato janë varreza aktuale pronarët i kanë leshu ato atëherë me kohë,varrezat private janë të lëshuara me mirëkuptim nga qytetaret,por është e përcaktuar me ligj sa ki drejt me ndryshuar ti destinimin e varrezave sa i përket këmbimit ose shpronësimit te tyre ne nuk kemi mjete varrezat mbesin varreza.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend,edhe kjo pikë votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën e 6. Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr. 12-353-22880,të datës 29.06.2020 për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe në zonën kadastrave në Zabel i Epërm.
Tek kjo pike është një lëshim teknik.

Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani- siç e cekti edhe kryesuesi tek kjo pike është një plotësim ndryshim i vendimit paraprak i cili është votuar me herët ne mbledhjen e dt 29.06 .2020 në pikën dy është bërë një lëshim teknik në zonën kadastrale ne Abri të Epërm

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-gabimisht e kanë shtinë në atë pjesën ku është ne atë pjesën e parcelës që ka një prapështi të madhe,po tani e kanë kthyer në rrafsh,ky është ai ndryshimi

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend,edhe kjo pikë votohet.

Për votuan 6 anëtar.

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën e shatë. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrave në Baicë.

Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrave në Baicë.

Propozimi për këmbimin e këtyre parcelave është bërë me qëllim të realizimit të interesit publik të Komunës së Drenasit për projektin e funksionalizimit infrastrukturor, për rregullimin dhe asfaltimin e kësaj rruge, si dhe për realizimin e planeve zhvillimore të komunës.

Pronari i parcelës nr. 896-0, Ajet Tafë Kiqina me anë të kërkesës nr. 07-070/7611 datë 10.02.2020 i është drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë ku ka kërkuar që në marrëveshje me Kryetarin e Komunës të bëhet ky këmbim parcelash.

Këmbimet e këtyre parcelave janë të domosdoshme për banorët e kësaj ane, që të bëhet rregullimi i rrugës sipas standardeve infrastrukture, dhe planeve zhvillimore të Komunës së Drenasit. Faktikisht rruga të cilën e shfrytëzojnë banorët në përditshmëri kalon nëpër pronën private përkatësisht nëpër parcelën nr. 896-0, pronë private e Ajet Kiqinës, andaj është shumë e arsyeshme që të bëhet këmbimi i këtyre parcelave.

Këmbimi do të bëhet në atë mënyrë ku nga parcela nr. 896-0 pronë private e Ajet Kiqinës këmbehet sipërfaqja e përgjithshme prej S=736 m², dhe nga parcela nr. 01709-0 pronë komunale po ashtu do ti këmbehet sipërfaqja e njëjtë prej S=736 m².

Ekipi profesional i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë ka dal në vend shikim dhe ka bërë inçizimin e pjesës së ngastrave kadastrale të shënuara më lartë të cilat do të këmbehen, e për të cilat pjesë janë nxjerrë edhe skicat grafike dhe certifikatat mbi të drejtat e pronës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci- kjo rrugë është ndërtua para qeverisjes tone, për mos me leju me na padit dhe me na marr shuma të mëdha për pronat siç ka ndodh në Tërstenik nuk e kanë bërë rrugën ka qene publike dhe për një ari 28.000 € i ka marr përmbaruesi,në rastin pronari ka pranuar ne e kemi drejt si komune me ndërrua parcelat tona me sipërfaqe të njëjtë kur është në interes të komunës,pra ne kemi interes edhe për këtë arsye është kërkuar me bërë plotësim ndryshim.

Edolina Plakqi- vetëm desha me pyet për këtë rrugën a ka u lidh me lagjen topalli apo me cilën pjesë e rrugës është me saktësisht në Baic .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend,edhe kjo pikë votohet në mënyr unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën e 8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020.

Drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Arsim Haxhiu - Propozim Vendim për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020. Duke pasur parasysh situatën e krijuar pas shfaqjes së virusit COVID-19, vendimit Nr. 01/11, të datës 15.03.2020, për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, Vendimeve dhe Urdhërësave të Ministrive përkatëse lidhur me masat për parandalimin e virusit, rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik

(IKSHP) dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) për ndërmarrjen e masave për parandalimin e pandemisë, kërkohet lirimi nga pagesa e qirasë joprofitabile për të gjitha familjet përfituese të shfrytëzimit të Banimit të Përkohshëm Social në Bllokun I dhe II, në Drenasin III për vitin 2020, familje këto të përfshira në vendimin 12 Nr. 360-68569 të datës 29.11.2019 të Kuvendit Komunal të Komunës së Drenasit.

Ky propozim drejtohet duke pasur parasysh gjendjen sociale- shëndetësore të këtyre familjeve, si dhe vështirësitë ekonomiko- financiare të shkaktuara në këtë gjendje të pandemisë.

Burim Bujupi-a lirohen prej qiraje gjatë tërë vit apo vetëm prej muajit të ardhshëm kur të merret vendimi në Kuvend,normal që pajtohem edhe shumë mirë që ka ardh si pikë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj - i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend,edhe kjo pikë votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj -hapi për diskutim pikën e 9. Propozim Vendim për caktimin e Lokacioneve për ndërtimin modernizimin dhe kompletimin e infrastrukturës përcjellëse të studionit të qytetit "Rexhep Rexhepi" në Poklek të Ri.

Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani- Punimet në Stadiumin e qytetit janë duke vazhduar sipas planit dinamik, dhe tani punimet e fazës së dytë janë në përfundim e sipër, prandaj mbase përfundimit të kësaj faze të punimeve është e paraparë faza e tretë e punimeve për zgjerimin dhe implementimin e infrastrukturës përcjellëse të Stadiumit, andaj për tu kryer punët sipas standardeve të kërkuara është e domosdoshme të miratohet ky vendim dhe të caktohen lokacionet e shënuar më lartë. Po ashtu edhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Drenasit me anë të kërkesës nr. 10-942/05-26151, të datës 17.07.2020, i është drejtuar Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, të inicioj procedurat për caktimin e lokacioneve në pronat komunale për realizimin e projektit të ndërtimit të infrastrukturës përcjellëse të Stadionit të qytetit 'Rexhep Rexhepi' në Poklekt të Ri. Drejtorati për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë ka caktuar ekipin profesional i cili ka përcaktuar dhe ka bërë matjet gjeodezike të lokacioneve për Stadionin e qytetit. Pjesë përbërëse e këtij propozim-vendimi janë edhe Çertifikatat mbi të drejtat e pronës dhe kopjet e planit për ku do bëhen caktimet e lokacioneve.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-një here e kemi shpronësuar satdiumin po tani na duhet edhe një pronë 14 ari,një pjesë tjetër është të shkolla,po ashtu edhe tek halla e sporteve që prona është e komunës me sipërfaqe 80 ari, përpos këtyre ne duhet me gjet edhe prona tjera,për me na leju stadimun në kategorinë e katërt për me mund me luajtur ndeshjet ndërkombëtare deri ne 1.50 km na lejohet me qene parkingu larg stadiumit ,edhe parkingje e komunës hynë me ato te stadiumit

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend,edhe kjo pikë votohet në mënyr unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 10.Propozim Vendim për caktimin e Lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e Çerdhes në Komoran.

Drejtori për Gjeodezi Kadaster dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-Sipas kërkesës së Drejtorisë së Arsmi, nr.09-35/1-26261, të datës 17.07.2020, punimet për ndërtimin e çerdhes në Komoran

pritet të fillojnë shumë shpejt, andaj për tu kryer punët sipas standardeve të kërkuara është e domosdoshme të miratohet ky vendim dhe të caktohet lokacioni i shënuar më lartë, për arsye të realizimit të projektit për ndërtimin e çerdhes në Komoran. Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka caktuar ekipin profesional i cili ka përcaktuar dhe ka bërë matjet gjeodezike të lokacionit për ndërtimin e çerdhes në Komoran, sipas kërkesës së njësisë kërkuese Drejtorisë së Arsimit. Pjesë përbërse e këtijë propozim-vendimi janë edhe Çertifikatat mbi të drejtat e pronës dhe kopjet e planit për ku do bëhet caktimi i lokacionit.

Burim Bujupi –ky propozim a po hin se bashku me këto propozimet tjera për me kaluar për kuvend apo vetem si njoftim e kemi.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci –ky propozim për shpronësim ose ndërrim prone nëse ne pajtohemi me i ndërruar pronat.

Burim Bujupi – a është i njoftua pronari që komuna ka interes për me bërë shpronësimin e parcelës në fjalë që hyn për stadium edhe a ka kërkuar diçka ai, në qoftë se është i njoftuar pse mos me vendos si pikë të rendit të ditës me rekomandua për kuvend edhe me vazhdua me procedurat tjera.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci - unë nuk e di a është i njoftuar, por unë e kisha rekomandua për kuvend.

Burim Bujupi –atëherë unë mendoj që të rekomandohet për kuvend dhe atje e diskutojmë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, edhe kjo pikë votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj-hapi për diskutim pikën 1. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm Publik për kthimin e pronave të cilat janë nën menaxhimin e AKP-së, në zonat Kadastrale : Qikatovë e Re, Terstenik, Poklek , Korroticë e Poshtme, Zabel i Poshtëm, Komoran dhe Sankoc.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-ne jemi detyruar me kërkuar nga AKP-ja dhe qeveria me na jep, ose me na shit nëse nuk ka rrugë tjetër sepse komuna përfiton, prandaj i kemi propozua disa prona siç është stadiumi që ka me filluar me u ndërtuar në Komoran, kështu që ata kanë kërkuar nga ne që të shpallim interesin e përgjithshëm jo vetëm ne por për të gjitha komunat është bërë kjo.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, edhe kjo pikë votohet në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj rekomandon për kuvend Raporti Financiar i Zhvillimit të Buxhetit Janar Qershor 2020 .

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- tek pika të ndryshme a ka ndonjë pyetje?

Burim Bujupi-në qoftesë ka mundësi kryetari me na treguar rreth situatës së pandemisë momentalisht si është gjendja në komunën e Drenasit, sepse ne fshatin tim Arllat ka pasur shumë persona të prekur me covid, dhe me kanë thirrur mu në telefon ,dhe a ka mundësi të paktën neve asambleistave me na informua për personat janë të prekur me covid nëse lejohet edhe me dit, për shkak se pa ka shumë njerëz të prekur edhe ne nuk po jemi të informuar jo vetëm na por edhe pjesa tjetër e shoqërisë dhe për këtë arsye shpërndarja po bëhet edhe me e madhe të paktën me dit edhe me lokalizua se ata po dalin po shëtisin edhe po i rrezikojnë edhe të tjerët, unë për një rast e kam thirr Arben Shalën edhe mu ka lajmëruar i kam treguar për personin në fjalë që është i

infektuar dhe brenda orës i është bërë zgjidhja i janë dërguar ndihmat dhe me ka ardhur shumë mirë ,por si të ja bëjmë për një pjesë tjetër që punojnë në sektorin e ndërtimtarisë dhe nuk kanë të hyra mujore dhe kanë mbete shumë keq.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci-të hënën e kaluar ne kemi pas mbledhje të shtabit emergjent dhe me kërkesë të qeveris sepse pas lirimit të masave ne skemi ,pas pse me mbajt mbledhje meqenëse qytetaret kanë mund me lëviz,tani ne e kemi riaktivizim shtabin emergjent dhe qëndren operativ, dhe nën shtabet neper lokalitete tona kushdo që ka kërkuar ndihme të ne mënyrë zyrtare që ka qenë ai apo familja e tij ne i kemi ofruar ndihme i kemi dërguar mjeket dhe policin si dhe drejtori i shëndetësisë dr.Arsim Haxhiu ia ka bërë një vendim për vet izolim për 14 ditë,çdo dit shkon stafi shëndetësor dhe policia me verifikuar a janë njerëzit aty.

Burim Bujupi-faleminderit për sqarimin kryetar por një pjesë e madhe e qytetareve nuk kanë kartela qe marrin pagë mujore ,dhe porosia online për gjera ushqimore unë nuk e di që mundet me bërë nga ndonjë market , nëse din ti me trego,sepse nesër pas nesër edhe unë mundem me qenë i infektuar.


Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11: 30 min.

Drenas 24.07.2020

Procesmbajtëse:


Fakete Hoti


Kryesuesi i Kuvendit

Vabinot Halilaj

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLOGOC
GLOGOC MUNICIPALITY

17 28 2020			
NR. OR.	NR. Y.	UJLA	VOT.
015	030	329102	



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS



**RAPORTI I PUNËS JANAR-
QERSHOR 2020 I
KRYETARIT DHE QEVERISJES
LOKALE**



DRENAS
2020

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

PËRMBAJTJA

1. ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS	3
1.1. ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN	4
1.2. ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM.....	5
1.3. ZYRA E PERSONELIT	6
1.4. ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE).....	8
1.5. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....	9
1.6. ZYRA PËR BARAZI GJINORE.....	9
2. RAPORTET SIPAS DREJTORIVE	10
2.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME.....	10
2.2. DREJTORIA E ARSIMIT.....	16
2.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	19
2.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)	28
2.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT.....	30
2.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	34
2.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE.....	35
2.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	47
2.9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....	49
2.10. DREJTORIA PËR SHËRBBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË	54
2.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE.....	60
2.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK.....	66

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISËS LOKALE

1. ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

Në periudhën raportuese janar-qershor 2020 të kryetarit, janë regjistruar përmes intranetit të brendshëm (arkivit aktiv) 934 lëndë të ndryshme nga qytetarët, të cilave i është përgjigjur. Janë nxjerr 125 të ndryshme, të cilat janë publikuar edhe në ueb faqen e Komunës. Zyra e kryetarit ka organizuar një (1) takim me publikun sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, për të diskutuar aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Po ashtu është mbajtur një (1) dëgjim për buxhet 2021-2023 për kërkesat fillestare me qytetarët e Komunës së Drenasit. Ndërsa janë mbajtur edhe tri (3) takime të tjera me qytetarë për t'i diskutuar dokumente strategjike të Komunës. Një (1) takim është mbajtur për të diskutuar Planin Zhvillimor Komunal të Drenasit 2020-2028, një (1) takim është mbajtur për të diskutuar Rregulloren për Organizimin e Punës në Institucioneve Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit dhe një (1) takim me publikun për Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr.Hafir Shala" në Drenas. Po ashtu janë mbajtur edhe 4 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), tre (3) prej tyre të rregullta dhe një (1) e jashtëzakonshme. Po ashtu janë mbajtur edhe 29 mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe 10 mbledhje të Shabit Emergjent dhe Qendrës Operative. Për shkak të gjendjes së pandemisë globale të COVID-19, shumë projekte e aktivitete janë stagnuar, megjithatë, angazhimi i ekzekutivit nuk ka munguar që gjatë kësaj periudhe të kryhen të gjitha punët e planifikuara. Komuna e Drenasit, që nga momenti i shpalljes së Emergjencës së Shëndetit Publik në Republikën e Kosovës i ka përcjellë me vëmendje të gjitha vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke i postuar të njëjtit në ueb faqen e Komunës së Drenasit, në të njëjtën kohë duke bërë thirrje që këto vendime të respektohen në përpikëri, duke mos paragjykuar kushtetutshmërinë e tyre. Fillimisht me datë 12.03.2020, është formuar Shtabi Emergjent Lokal (Vendimi Nr.01-020/04-13622). Pastaj, Drejtoria e Shëndetësisë ka nxjerrë vendimin Nr.06-052/01-1942, me datë 16.03.2020 për prioritetet e QKMF-së në Drenas, duke u bazuar në vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Po ashtu Inspektorati Komunal në vazhdimësi ka mbikëqyr zbatimin e këtyre vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, duke qenë në teren gjatë gjithë kohës. Në Komunën e Drenasit nga data 13.03.2020, vendimet e nxjerra që lidhen me gjendjen e krijuar me Covid-19 janë gjithsej 55 vendime (duke përjashtuar vendimet tjera administrative).

Vlen të theksohet së Komuna e Drenasit ka formuar Shtabin Emergjent me datë 12.03.2020, një ditë para se të shpallet gjendja Emergjencës së Shëndetit Publik në Kosovë (vendimi Nr. 01-020/04-13622). Nënshatabin Emergjent është formuar me datë 02.04.2020 (vendimi Nr. 01-030/01-142020). Qendrën Operative Emergjente Lokale është formuar me datë 15.04.2020 (vendimi Nr.01-020/04-14533).

Ndërsa ajo që është më e rëndësishme, Komuna e Drenasit gjatë kësaj periudhe është kujdesur që të menaxhojë shpërndarjen e donacioneve të ndryshme. Për këtë është krijuar një mënyrë e komunikimi e drejtpërdrejtë me administratorët e vendbanimeve e përmes tyre me përfaqësuesit e lagjes me qëllim të identifikimit të nevojtarëve realë dhe me qëllim të shmangies së përfituesve të dyfishtë apo trefishtë.

Asambleja Komunale me qëllim të menaxhimit të situatës se krijuar pas shfaqjes së COVID-19 ka ndarë shumën prej 229,200.00 Euro, cila kishte për qëllim blerjen e pakove ushqimore dhe

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISSES LOKALE

higjienike, me qëllim që familjet e zëna ngushtë nga pandemia të ndihmohen. Prej tyre janë shpenzuar 85,000.00 Euro, ku procedurat janë monitoruar edhe nga legjislativi. Për këtë qëllim ne kemi krijuar edhe Komisionin i cili është përkujdesur për shpërndarjen e ndihmave. Në ditët e para pas pandemisë kemi pranuar një donacion prej 200 thasëve miell dhe 400 litrave qumësht e 400 litra lëngje nga ELKOS dhe Devolli të cilat u janë shpërndarë familjeve të cilat kanë qenë në nevojë imediate, të cilat lista i kanë ofruar Administratoret e Vendbanimeve. Po ashtu kemi shpërndarë 50 pako ushqimore dhe higjienike, për banoret të cilët jetojnë në banesat e socialit në Çikatove të Re, donacion nga fondacioni “Jetimet e Ballkanit”. Pastaj kemi shpërndarë 600 pako ndihmë ushqimore dhe higjienike me vlerë prej 30,000.00 Euro, të blera nga buxheti komunal nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e të cilat sipas vlerësimeve tona kanë lehtësuar jetesën e familjeve në nevojë, e cila shpërndarje është bërë sipas listave të ofruara nga Administratoret e Vendbanimeve. Po ashtu Komuna e Drenasit nga buxheti i saj ka blerë 2.000 pako ushqimore dhe higjienike në vlerë prej 85,000.00 Euro, të cilat po ashtu janë shpërndarë sipas listës së ofruar nga Administratoret e Vendbanimeve. Pako me përmbajtje të njëjtë në sasi prej 100 njësi kemi pranuar donacion nga *Islamic Relief*, dhe 100 nga kompania *ATC*. Prej kësaj sasi 160 janë shpërndarë për punëtorët shëndetësorë në shenjë falënderimi për kontributin e tyre gjatë pandemisë, ndërsa pjesa tjetër prej 40 pakosh ka shkuar për kompaninë *Pastrimi*. Pas kësaj kemi pranuar edhe 210 pako donacion nga Feronikeli dhe 200 nga Katari, gjithashtu të njëjtat janë shpërndarë sipas listës së ofruar nga Administratoret e Vendbanimeve. Gjatë kësaj kohe kemi pasur shumë donacione miell. Gjatë javës së parë të prillit kemi shpërndarë 1011 thasë miell për të gjithë përfutuesit e skemës sociale në Komunën e Drenasit, pastaj me 21 maj, janë shpërndarë 907 thasë miell për nevojtarët sipas listave të hartuara nga Administratoret. Totali i miellit duke përfshirë edhe miellin e pakove arrin afërsisht 146 000 kg që i bien afërsisht 3 kg për kokë banori. Vlen të theksohet se komunikimi me Administratoret e Vendbanimeve ka qenë transparent, në të njëjtin grup ku është zhvilluar komunikimi kanë qenë të përfshirë edhe asamblastët. Një bashkëpunim të mirë kemi pasur me Kryqin e Kuq, dega në Drenas dhe sipas informacioneve që na kanë përcjellë ata kanë shpërndarë 192 pako ushqimore dhe higjienike dhe 391 pako higjienike. Kemi përkrahur edhe kategoritë që kanë qenë tepër të ngarkuara me punë ose të marginalizuara si zjarrfikësit, prindërit vetushqyes, Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave, persona në hemodializë, HANDIKOS-in, banorët që janë të vendosur në banesa të socialit si dhe disa kërkesa tjera specifike.

1.1. ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN

Zyra për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës raportuese, ka përcjellë aktivitetet ditore, javore dhe mujore të Komunës. Përmes linkut zyrtar <http://kk.rks-gov.net/glllogoc/>, ueb faqes së Komunës, ka publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe ka publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, projektet, njoftimet, konkurset, njoftimet e zyrës së prokurimit si; kontratat e nënshkruara, njoftimet për anulim, njoftimet për dhënien e kontratave, njoftimet për kontratë, njoftimet për nënshkrimin e kontratave dhe shkresa të tjera në interes të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me media, ku i ka përcjellë njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa, reagime etj., ku gjithsejtë ka lëshuar mbi 300 komunikata. Ka përcjell agjendën e Kryetarit dhe ka caktuar takime në bashkëpunim me Kryetarin me delegacione të ndryshme nga niveli qendror dhe ai lokal, si dhe më delegacione të ndryshme ndërkombëtare. Në kuadër të kësaj zyre, janë pranuar dhe shqyrtuar edhe kërkesat për qasje në dokumente publike dhe gjatë periudhës raportuese janë

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

pranuar 10 kërkesa për qasje dhe të gjitha kanë qenë të qasshme. Ju ka përgjigjur të gjitha OJQ-ve për plotësimin e formularëve të pyetjeve të dërguara dhe kontakti i përhershëm me Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal si dhe me nivele të tjera qeveritare. Po ashtu ka mbajtur kontakte të rregullta me media dhe i ka kthyer përgjigje të gjitha atyre që janë interesuar për çështjet e Komunës së Drenasit.

1.2. ZYRA E AUDITORIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm është e përbërë prej dy auditorëve, Drejtorin e Njesisë dhe një Auditor. Kërkesat ligjore janë që ne të kemi së paku edhe një auditor për shkak të buxhetit mbi 15 milion dhe për shkak të numrit të personelit 1.325, mirëpo në mungese të masës buxhetore për paga dhe në mungesë të numrit të certifikuar për punëtorë të rinj, nuk kemi pasur mundësi që ta rrisim numrin e auditorëve. Njësia e Auditimit të Brendshëm në fund të vitit 2019, ka hartuar dhe aprovuar para Komitetit të Auditimit të Brendshëm, Planin Strategjik të zhvillimit të aktiviteteve audituese për vitet 2020 -2022 si dhe duke u bazuar në këtë Plan, ka miratuar edhe Planin vjetor të Punës për vitin 2020. Me Planin e Punës së kësaj Njësie, për vitin 2020 janë paraparë që të kryhen gjithsej gjashtë auditime të rregullta. Deri me 30.06.2020 janë finalizuar tri Raporte të auditimit për tri auditimet e kryera sipas Planit të Punës. Auditimet e planifikuara dhe të kryera kanë pasur për qëllim që të arrihen objektivat kryesore si:

- Arritja e një pajtueshmërie të plotë me kornizën ligjore
- Ruajtja dhe menaxhimi i mirë me pasuritë e komunës;
- Shfrytëzimi më ekonomik i pasurisë komunale dhe rritja e vlerës së kësaj pasurie;
- Shfrytëzimi më ekonomik i resurseve humane në dispozicion të komunës;
- Shtimi i sigurisë dhe integritetit të të dhënave të pasqyruara;
- Rritja e vlerës së burimeve humane dhe material; dhe
- Krijimi i një qeverisje të mirë të bazuar në rrezik

Të gjitha raportet e finalizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm janë shqyrtuar nga ana e Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe janë nxjerrë konkluzionet për hapat që duhet të ndërmerren për jetësimin e rekomandimeve të Auditorit. Komiteti i Auditimit të Brendshëm është rifreskuar me anëtarë të ri dhe ka qenë mjaft aktiv gjatë kësaj periudhe. Deri me tani janë mbajtur gjithsej tri takime të këtij Komiteti, ku janë shqyrtuar dhe aprovuar Planet Strategjike të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, raportet e finalizuara për auditimet e kryera nga kjo njësi, si dhe Raportet periodike tremujore për aktivitetet audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Po ashtu ky Komitet ka hartuar dhe dorëzuar Raportin vjetor të punës për vitin 2019 siç parashihet me Ligj. Njësia e Auditimit të Brendshëm gjatë këtij gjashtëmujori ka hartuar dhe miratuar para Komitetit të Auditimit edhe Statutin e Njesisë duke e përshtatur atë më rregullativen ligjore më të re. Po ashtu gjatë kësaj periudhe është raportuar dy here në baza tremujore tek Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave. Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ndërmarr një qasje gjithëpërfshirëse dhe profesionale për ofrimin e rekomandimeve të dobishme për

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

menaxhmentin e komunës. Situata e përgjithshme me pandeminë Covid-19 ka ndikuar në vështirësimin e kryerjes së aktiviteteve të planifikuara për shkak të kufizimeve dhe mungesës së herëpashershme të stafit, mirëpo deri më tani kjo Njësi është në përputhje me aktivitetet e planifikuara në fillim të vitit. Gjatë këtij aktiviteti ka zhvilluar intervista me menaxherët dhe ka shqyrtuar mostra për të identifikuar shkallën e implementimit të rekomandimeve dhe aktivitetet që janë ndërmarrë në këtë drejtim. Fushat e audituara gjatë këtij gjashtëmujori kanë qenë:

1. Menaxhimi me pasuritë e Komunës të krijuara nga investimet kapitale dhe pasuritë tjera të lëvizshme kapitale jo financiare
2. Menaxhimi me pronat komunale (pasuritë e pa luajtshme), dhe
3. Auditimi i proceseve të inkasimit të të hyrave vetanake nga dhënia e pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

Gjatë kësaj periudhe janë dhënë gjithsej 13 rekomandime dhe shumica prej tyre janë implementuar ku janë ndërmarrë një numër i madh i aktiviteteve për adresimin e drejtë të tyre. Menaxhmenti i komunës ka ndërmarrë gjithsej 17 aktivitete konkrete për jetësimin e rekomandimeve dhe edhe përkundër kohës së shkurtër, mbi 70 % të rekomandimeve janë implementuar dhe një numër i rekomandimeve të cilat janë dhënë në kohën e fundit janë në proces të adresimit të tyre. Ne inkurajojmë Drejtoritë dhe sektorët që edhe më tutje të shtojnë aktivitetet e tyre për jetësimin e rekomandimeve që janë në proces të implementimit. Gjithashtu falënderojmë menaxherët të cilët kanë arritur që të implementojnë rekomandimet e dhëna deri më tani.

1.3. ZYRA E PERSONELIT

Për 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2020, Zyra e personelit ka azhuruar listat e pagave sipas ndryshimeve, konformë zhvillimeve në stafin e punëtorëve. Edhe pse planifikimi me planin e personelit për vitin 2020, është dërguar me kohë në DASHC/MAP, nuk është zhvilluar asnjë procedurë rekrutuese për kërkesat e njësive kërkuese për pozitat e lira të rregullta. Në 6 (gjashtë) mujorin e parë janë aprovuar vetëm 3(tri) kërkesa prej DASHC-së për pozitat e Drejtorëve të Shkollave, pozita të planifikuara me PP.

Paraqitja në formë tabelare e realizimit sipas azhurimit në listë të pagave:

Muaji-viti	Punëtorë i ri	Ndryshime	Punëtorë të larguar	Pagesa retroaktiv	etj
Janar 2020	2 pozita Emr. të drejtorëve dhe 2 pozita KK.	2 pozita të drejt.levizje të brend. dhe 2 ndry.	1		1 transfer bankar
Shkurt 2020	6 KK. dhe 1 AAKOM	12	1	6	1 transfer bankar
Mars 2020		4		2	2 transfer bankar
Prill 2020			1	10	1 transfer bankar
Maj 2020		1		9	2 transfere bankare

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Qershor 2020		2	1	1	1 transfer bankar
--------------	--	---	---	---	-------------------

Nga muaji Janar 2020, zyra e personelit me kërkesë të MAP, USAID, IKAP, ATK, ka përgatitur planin për trajnimin e stafit (shërbyesve civil). Duke ju referuar vendimit të Qeverisë (11 mars 2020), informohemi nga përgjegjësit për trajnimin e stafit (shërbyesve civil) se të gjitha aktivitetet e trajnimit anulohen nga 12 mars 2020. Është përgatitur lista e të dhënave të punësuarave në shërbimin civil, për staf në arsim, në shëndetësi, staf politik, staf mbështetës dhe i është dërguar përmes formularit (Moduli i Statistikave) në SIMBNJ. Bazuar në Rregulloren për pushimin e nëpunësve civil 06/2011 për vitin 2020; është përgatitur Plani Orientues i shfrytëzimit të pushimeve vjetore për nëpunës civilë. Në bazë të kërkesës së DKA-Drenas, për plotësimin e tri (3) pozitave të lira të punës për Drejtor të Shkollave; Drejtor të SHML dhe SHFMU sipas sistemit të SIMBNJ janë shpallur konkurset publike dhe janë në procedurë rekrutuese. Me plan individual të personelit për vitin 2020 kërkesat e planifikuara për pozita të lira të njëjësive kërkuese janë të paraqitura në DASHC për aprovim prej fillimit të vitit 2020. Arsyeja e mos aprovimit të të kërkesave për pozita të lira nga DASHC/MPB është se jemi në pritje të fillimit të zbatimit të Ligjit për Zyrtarë Publikë. Konkurs me marrëveshje për shërbime të veqanta për muajin Janar – Qershor 2020

Forma tabelare e konkurseve:

Muajt:	Lloj konkursit	Nr. Pozitave të shpallura	Nr. Pozitave të realizuara	Numri i pozitave të anuluar	Ankesat
Janar 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	Pesë(5) pozita 1 Zyrtar Ligjor/ZK 1 Zyrtar adminis./DAP 1 Zyrt.për çesht.pro./DK. 1 Zyrt.admminist/DKGJ. 1 Arkëtar- DBPZHR	5 pozita të realizuara		Nuk ka pasur ankesa,
Janar 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta për 10 (dhjetë pozita)	Për 10 (dhjetë pozita) 1 Zyrt.stad.sinteti/DKRS 1 Zyrt.pale.sporti/ DKRS 2 Mirëmb-punëtor teknik në stadiu. Sintetik/ DKRS 2 Mirëmbajtës-punëtor tekni.në Pale.spor/ DKRS 2 Zyrt.për Bujq/DBZHR 2 Zyrt.për Shër.Soc/QPS	10 (dhjetë pozita) të realizuara		Nuk ka pasur ankesa,

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

24 Dhjetor 2019	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	Për 7 (shtatë pozita) 1 Inspektor i Inspektor i Mjedisit/DI 1 Zyrt.për shërb.të trans lokal/DSHPE 1 Zyrtar administrativ 2 Zyrtar për prokurim/DAP 1 Zyrtar për mbroj.të mjed./DUPH 1 Roje pylli/ DBZHR	7 (shtatë pozita) të realizuara		Nuk ka pasur ankesa,
Shkurt 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	Për 2 (dy pozita) 1 Zyrtar për futjen e të dhënave/DZHE 1 Zyrtar Ligjor/DIL	2 (dy pozita të realizuara)		Nuk ka pasur ankesa,
Shkurt 2020	Konkurs me Marrëveshje për Shërbime te Veçanta	1 Zyrtar Ligjor/ DUPH			

Në muajin Qershor 2020, Auditorët e jashtëm- Kërkesat janë; Akt Emërimet, Lista e pagave për muaj të caktuar, lista e pensioneve me arritjen e moshës dhe lista e pushimeve të lehonisë, auditimi i pozitave të rregullta të rekrutimit për vitin 2019, auditimi i procedurave rekrutuese për punëtorët e pranuar me marrëveshje për shërbime të veçanta për vitin 2019, kualifikimi (diplomë ose certifikatë), lista e hyrje - dalje të zyrtarëve, pushimet vjetore, punë shtesë të shërbyesve civil për 2019. Po ashtu zyra e Personelit dhe njësia e personelit sipas detyrës zyrtare dhe sipas Rregullores nr.05/2011 ka rolin e sekretarisë për përgatitjen e seancave sipas ankesave, në KZKA dhe e njëjta vlen edhe sipas Rregullores 04/2011 të komisionit disiplinor, gjatë kësaj periudhe ku janë zhvilluar seancat: Ankesat kanë qenë; ankesa shkelje e të drejtës në pagë, ankesa lidhur me transferimin brenda institucionit, ankesa për masë disiplinore, ankesa për 3 paga përcjellëse me rastin e pensionimit. Zyra e personelit është përgjegjës dhe ka plotësuar dokumentacionin në bazë të detyrës zyrtare edhe sipas kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me rastet ankimore.

1.4. ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE (ZKIE)

ZKIE- Harton dhe miraton plane, projekte dhe ofron shërbime përkatëse në fushën e integrimeve evropiane, ofron përkrahje, këshilla dhe ekspertizë profesionale drejtuesve në fushën e integrimit evropian duke marr parasysh obligimet që dalin nga të gjitha dokumentet strategjike kombëtare rreth integrimit evropian dhe marrëdhënieve në Kosovë. Siguron që ndihma e jashtme është e ndërlidhur dhe kontribuon në zbatimin e prioritetëve dhe planeve të institucionit, koordinon dhe konsultohet me institucionet përgjegjëse dhe me institucionet e tjera të jashtme përkatëse për fushën e integrimeve evropiane me qëllim të harmonizimit të prioritetëve dhe politikave, merr pjesë në përcaktimin dhe planifikimin e aktiviteteve të ministrisë në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare për integrim evropian, koordinon dhe bashkëpunon me zyrën e personelit për ngritje të kapacitetit të stafit për çështjet e ndërlidhura me integrim evropian, ofron udhëzime për stafin e nivelit më të ulët

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISËS LOKALE

të njësisë organizative në bërjen e hulumtimeve, përgatitjen e raporteve dhe ofrimin e këshillave rreth çështjeve të integritetit evropian, duke kontribuar në punën e tyre sipas nevojës monitoron produktet.

ZKIE gjatë periudhës Janar –Qershor 2020 ka kryer punët dhe detyrat e punës në bazë të planit të punës përshkrimi të detyrave të punës dhe Rregullores Qeverisë 08/2011. Programi Kombëtar për Zbatim të MSA-së që është dokument ligjor i detyrueshëm për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe Komuna, ku në nivelin lokal kemi Planin e veprimit të obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane. Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi përcjell raporte sipas kërkesës së Ministrisë për Integritet Evropiane, kemi koordinuar punën me Drejtorët e drejtorive e shefa të sektorëve dhe Udhëheqësin e personelit për identifikimin e nevojave për trajnime për stafin civil të Komunës së Drenasit. Është raportuar më kohë kryetarit dhe MPL-së për Përmbytjen e Obligimeve nga Agjenda Evropiane për periudhën Janar-Qershor 2020 për Komunën e Drenasit. Në muajin Korrik është bërë përpilimi i Raportit të Përmbytjes së obligimeve të cilat dalin nga Agjenda Evropiane dhe është përcjellë për Ministrinë e Integritetit Evropiane. Në këtë raport janë të përfshira të dhëna lidhur me Zyrën për Integritet Evropiane si dhe mbi përmbytjen e obligimeve të Komunave të cilat dalin nga Agjenda Evropiane, për periudhën Janar - Qershor 2020.

1.5. ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, këshillon autoritetet komunale në lidhje me nevojat e komuniteteve pakicë që jetojnë në Komunën tonë, të siguroj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre, qasje të barabartë të gjitha komuniteteve në shërbimet publike dhe të krijoj kushte për një kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar që u përkasin të gjitha komuniteteve. Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim gjatë periudhës raportuese (janar-qershor 2020) ka pasur për fokus personat e riatdhesuar. Gjatë kësaj kohe kemi 1 (një) person të riatdhesuar. Gjatë këtij 6 muaji kemi lëshuar 3 (tre) vërtetime për personat e riatdhesuar.

1.6. ZYRA PËR BARAZI GJINORE

Zyra për Barazi Gjinore në Drenas Siguron rekomandime dhe këshilla profesionale Kryetarit të Komunës në formulimin e politikave gjinore dhe integritetin e komponentit gjinor në dokumente strategjike dhe planprogrameve lokale, merr pjesë dhe kontribuon në hartimin e politikave publike në të gjitha nivelet, në kuadrin e grupeve punuese koordinon, zbaton monitoron dhe raporton në institucionin ku bën pjesë, mbi aktivitetet që burojnë nga Programi për Barazi Gjinore për Kosovën në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara në program. Mbledhë dhe përpunon të dhëna me bazë gjinore, të natyrës cilësore dhe sasiore, mbi zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, Programin për Barazi Gjinore të Kosovës dhe të gjitha strategjitë dhe planprogramet në zbatim të hartuara nga komuna ose nga niveli qendror ofron raportime cilësore për Agjencinë për Barazi Gjinore për aspekte barazisë gjinore, në pajtim me kriteret dhe standardet e vendosura për raportim, për të gjitha politikat publike të aprovuara nga Qeveria e Kosovës dhe konventat ndërkombëtare këshillon Njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, mbi kriteret gjinore në procesin e punësimit me qasje të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas legjislacionit në fuqi. Bashkëpunon me komunitetin e OJQ-ve dhe partnerë të tjerë potencialë vendor dhe ndërkombëtarë, për koordinimin e aktiviteteve mes institucioneve, sigurimin e burimeve financiare për zbatimin e politikave publike dhe për ngritjen e

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

kapaciteteve institucionale. ZBGJ gjatë periudhës Janar - Qershor 2020 ka kryer punët dhe detyrat e punës që dalin nga fushëveprimtaria e saj në bazë të planit të punës dhe përshkrimit të detyrave të punës. Gjatë muajit Mars Me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në sallën e Kuvendit Komunal është mbajtur një takim i organizuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me të gjitha punonjëset e administratës komunale, të cilave iu janë dhuruar edhe buqeta me lule. Gjatë këtij takimi Kryetari Lladrovci ka theksuar se Komuna e Drenasit mbetet komunë lidere sa i përket besimit në aftësitë dhe shkathtësitë e grave, ku 6 nga gjithsej 12 drejtori udhëhiqen nga gratë/femrat, ndërsa pjesa dërrmuese e stafit të administratës komunale janë femra. ZBGJ-ja gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme ka planifikuar bashkëpunim me institucionet relevante për promovimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, integrimin e prespektives gjinore “Të drejta të barabarta për burrat dhe gratë”, aktivitete për promovimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe ligjit kunder Diskriminimit, dhe një varg aktivitete të tjera në data të caktuara të cilat për shkak të situates në vend të shkaktuar si rezultat i pandemisë janë bërë të pamundura që të realizohen gjatë periudhës raportuese.

2. RAPORTET SIPAS DREJTORIVE

2.1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Periudha raportuese gjashtëmujore e punës në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme përfshinë fushat nga Sektori i Gjendjes Civile, Zyra e Prokurimit, Qendra për Shërbime të Qytetarëve, Shërbimit të Kuvendit të Komunës, Sektori për Teknologji Informative dhe Logjistikë si dhe Sektorit të Arkivit Komunal.

I. Sektori i Gjendjes Civile:

Në sektorin e Gjendjes Civile prej datës 01.01.2020 deri me 30.06.2020 janë lëshuar këto dokumente:

1. Ekstrakte të Lindjes - 8001 copë
2. Certifikata të lindjes - 3187 copë
3. Certifikata të martesës - 2257 copë
4. Certifikata të vdekjes - 561 copë
5. Certifikata të vendbanimit – 2060 copë
6. Certifikata të bashkësisë familjare - 1863 copë
7. Certifikata të gjendjes martesore - 496
8. Certifikata të shtetësisë – 89 copë
9. Vërtetime nga arkiva 232 copë

Gjithsejtë certifikata të lëshuara - 16 946 copë

Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror - 474

Aktvendime për regjistrim të mëvonshëm të lindjes, vdekje, ndërrim, korrigjim i emrit personal për gjashtëmujorin 2020 janë: **124 aktvendime.**

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Lëndë për humbjen e shtetësisë së Kosovës me lirim janë: **22 lëndë**.

Lëndë për fitimin e shtetësisë së Kosovës janë: **3 lëndë**.

II. Zyra e Prokurimit

Gjatë periudhës 01.01.2020 – 30.06.2020 në Zyrën e Prokurimit Publik janë bërë kërkesa për blerje dhe zhvillim të procedurave të prokurimit nga të cilat:

1. Administrata komunale 62
2. Institucionet arsimore 17 dhe
3. Institucionet shëndetësore 06

Nga këto kërkesa kjo Zyrë ka zhvilluar **64 procedura**, prej tyre për:

1. Vlera minimale 22
2. Kuotime të çmimeve 4
3. Punë shtesë 0 dhe
4. Procedura të hapura 28 (punë 22, koncesione 0, kontrata kornizë 4, furnizim 3 dhe shërbime 3) = 32
5. Procedurë me negociata 4
6. Anulime (2) dhe Ri-tenderime (2) të njoftimeve për kontratë

Janë nënshkruar **35 kontrata**, prej tyre për:

1. Vlera minimale 22
2. Vlera të vogla 4 (furnizime 1, shërbime 0 dhe pune 3) dhe
3. Vlera të mesme ose të mëdha 32 (Furnizime 3, shërbime 3 dhe punë 22 Negociata 4 = 32)

III. Qendra për Shërbime të Qytetarëve (QSHQ):

Qendra për Shërbim të Qytetarëve gjatë periudhës 01/01/2020-30/06/2020 ka regjistruar gjithsejtë 10 759 lëndë të klasifikuara sipas shenjave klasifikuese, siç janë:

- Janar: janë regjistruar 2 282 lëndë të ndryshme;
- Shkurt: 2 484 lëndë;
- Mars: 1 516 lëndë;
- Prill: 398 lëndë;
- Maj: 1 313 lëndë;
- Qershor: 2 766 lëndë.

Qendra për Shërbim të Qytetarëve përmes sistemit elektronik ka ofruar të gjitha shërbimet për qytetarët, ka pranuar dhe regjistruar të gjitha lëndët që u janë drejtuar organeve komunale. Në këtë sektor është dhënë prioritet në ofrimin e sa më shumë shërbimeve, duke krijuar mundësinë që qytetarët fare të mos frekuentojnë fizikisht në zyrat e komunës. Bazuar në rregullativën ligjore, Qendra për Shërbim të Qytetarëve ka përmbushur të gjitha objektivat e parapara me planin e punës, për organizimin dhe funksionalizimin e QSHQ-së. Kemi punuar në kërkesa fillestare (në formë tabelare) për pagesa të shërbimeve dhe pagave të cilave ua kemi bashkangjitur edhe raportet për

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

pranim të shërbimeve. Gjatë kësaj periudhe kemi punuar në sistemin e brendshëm (intranet) ku i kemi bashkangjitur lëndët dhe kemi aprovuar/refuzuar lëndët e DAP dhe Zyrës së Prokurimit.

IV. Shërbimet e Kuvendit të Komunës

Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë periudhës janar-qershor 2020, ka organizuar dhe mbajtur mbledhjet për Komitetin për Politikë e Financa dhe mbledhjet e Kuvendit Komunal. Gjatë periudhës Kuvendi Komunal ka mbajtur gjithsejtë 12 mbledhje: prej tyre 5 mbledhje të rregullta të Kuvendit, 4 Solemne, 2 mbledhje urgjente dhe 1 mbledhje të jashtëzakonshme. Për 12 mbledhje të organizuara të Kuvendit janë shqyrtuar 67 pika të rendit të ditës: 50pika të mbledhjeve të rregullta, dhe 2 pikë në mbledhjen urgjente, dy pikë për mbledhje të jashtëzakonshme, 13 pika të mbledhjeve solemne.

Gjatë kësaj periudhe Kuvendi ka miratuar 33 vendime prej tyre 2 rregullore dhe një strategji.

Lëndë të miratuara gjatë periudhës Janar –Qershor në Kuvendin Komunal gjithsej janë 38

Gjatë periudhës Janar –Qershor, aktet të dërguara në MAPL janë dërguar gjithsejtë 22.

Zyra e Kuvendit ka pranuar nëntë (9), kërkesa për vërtetime të përvojës së punës në Kuvend, ku ka lëshuar 6 vërtetime dhe 1 një referencë për praktikë.

Në sistem të intranetit të gjitha lëndët e regjistruara të periudhës Janar - Qershor 2020, si dhe ju kanë bashkangjitur dokumentet siç janë: Ligjshmëritë e kthyer nga MAPL-ja për vendimet, faturat e shpenzimeve, vërtetimet e lëshuara sipas kërkesave.

V. Sektori për Teknologji Informative dhe Logjistikë

Raporti i punës bazohet mbi punët e kryera në baza ditore të domosdoshme dhe varësisht nga kërkesat e zyrtarëve komunal. Në raportet ditore që mban zyra për teknologji informative janë të specifikuar se tek cili zyrtarë është bërë intervenimi dhe çfarë problemi ka pasur.

Punët bazike të Zyrës së IT-së që janë kryer për këtë periudhë janë si në vijim:

- Kontrolli në dhomën e SERVER-ve dhe mirëmbajtja e SERVERA-ve (çdo ditë në fillim të orarit të punës)
- Kontrollimi i rrjetit në Komunë dhe në Zyrët Lokale të Gjendjes Civile , QKMF, QPS, ZP, QRA dhe QKRC (çdo ditë në fillim të orarit të punës)
- Aplikimi për kërkesat e zyrtarëve ne SMAED, SIMBNJ dhe kërkesa tjera.
- Dhënia e qasjes, trajnimi ne përdorim ne te gjitha E- shërbimet tek te gjithë zyrtaret
- Komunikimi me ministritë varëse rreth problemeve me rrjet dhe qasjeve te cilat kerkohen nga zyrtaret.
- Instalimet, Konfigurimet me asetet e komunës (pajisjet e teknologjisë, kompjuter, server, printer, telefona etj).
- Ruajtja e shënimeve të Zyrtareve nga MAP Draiveri në DATA CENTER
- Ndryshimet ne privilegjet e zyrtareve sipas kërkesave në aplikacione
- Mirëmbajtja e llogarive zyrtare, aktivizimi i llogarive te reja.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

- Menaxhimi i Activ Direcory
- Mbledhja e Kuvendit –Transmetim, incizim, votimi elektronik, postim ne ueb faqe.
-

P.S Për shkak të gjendjes së pandemisë me Covid -19, janë ndihmuar zyrtaret në përdorimin e platformave online për trajnime dhe komunikime nga distanca.

Raporti i punës në zyrën e Teknologjisë Informative: 03/01/2020 deri me 30/06/2020		
Zyrtari :Ukë Krasniqi		
Drejtoria	Kërkesa nga Zyrtari	Lloji i intervenimit - problemit
DAP	GJC	113 intervenime
DAP	QSHQ	125 intervenime
ZK		55 intervenime
DF		110 intervenime
DI		75 Intervenime
DKRS		118 intervenime
DSHMS		112 intervenime
DGJKP		98 intervenime
DUMM		105 intervenime
DIL		112 intervenime
DBP		92 intervenime
DZHE		74 intervenime
DA		135 intervenime
DSHPS		121 intervenime

- Zyrtari për Pranim të Mallit Depoistë dhe Logjistikë

Gjatë periudhës 01.01.2020-30.06.2020 janë kryer këto punë dhe detyra:

1. Regjistrimi i inventarit të Komunës së Drenasit në regjistrin e excelit në bazë të ditarëve të punuar nga komisioni për regjistrimin dhe vlerësimin e inventarit të komunës;

RAPORTI I PUNËS JAAAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

2. Azhurnimi i raportit për regjistrimin e Inventarit të Komunës, nga komisioni i caktuar për verifikimin e zyrtarëve të cilët nuk janë më pjesë e stafit të komunës;
3. Shkarkimi dhe ngarkimi i inventarit nga të gjithë zyrtarët e Komunës;
4. Pranimi, evidentimi i të gjitha kërkesave nga drejtoritë komunale për pagesën e faturave sipas kontratave të lidhura nga Zyra e Prokurimit për punët, furnizimet dhe shërbimet e kryera dhe të pranuar nga njësitë kërkuuese.
5. Në FREEBALANCE sipas GRNS - Raporte të Pranimi për të gjitha Njësitë Kërkuuese janë nxjerrë gjithsej 296 raporte për pagesa të ndryshme në bazë të faturave të pranuar nga të gjitha drejtoritë siç janë:
 - Drejtoria për Planifikim dhe D. Infrastrukturë 40 raporte nga Freebalanc, (GRNS)
 - Zyra e Kryetarit - 19 Raporte të GRNS-së
 - Zyra e Kuvendit - 16 Raporte të GRNS-së
 - Inspekcioni - 16 Raporte të GRNS- së
 - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik- 24 Raporte të pranimi të GRNS- së
 - Drejtoria për Buxhet dhe Financa- 11 Raporte të pranimi të GRNS- së
 - Drejtoria për Administratë - 107 Raporte të GRNS- së
 - Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport- 17 Raporte të GRNS- së
 - Drejtoria për Shërbime Publike - 36 të GRNS- së
 - Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë - 10 Raporte të Pranimi të GRNS- së.

Në sistemin e E-pasurisë janë regjistruar të gjithë artikujt sipas faturave nga Njësitë Kërkuuese për mallin e pranuar në E-Depo me vlerën nën 1000 euro, si më poshtë :

1. Raporti i pranimi të mallrave arrin vlerën 15.191.85 € ndërsa,
2. Raporti i daljes së mallrave është 15.191.17 €.

Të gjithë zyrtarët janë ngarkuar me mallin e porositur nga Njësitë Kërkuuese dhe janë nënshkruar në fletëngarkim.

- **Logjistikë (Zyrtari për mirëmbajtjen e veturave, shpërndarësi i postes, shtëpiaku/fokisti, recepsionisti):**

Zyrtari për mirëmbajtjen e veturave është përkujdesur për mirëmbajtjen e tyre, ka kryer të gjitha kontrollet e nevojshme të sigurisë, servisimit rutinor dhe regjistrimin e veturave zyrtare. Përdorimi i veturave për pune zyrtare është bërë duke u bazuar në kërkesat me email të zyrtarëve.

Shpërndarësi i postes ka bërë shpërndarjen e postës sipas kërkesave. Përcjellja e tyre është bërë me kohë, ku gjatë kësaj periudhe ka shpërndarë 640 shkresa të ndryshme (vendime, ftesa, kërkesa, ankesa etj) nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Drenasit dhe jashtë saj.

Shërbimet në mirëmbajtjen e objektit dhe inventarit nga ana e zyrtarit përgjegjës janë kryer sipas kërkesave për intervenim. Përkujdesa për mirëmbajtjen e sistemit energjetik në objektin komunale ka qenë në nivel, problemet të cilat janë paraqitur në kohë janë eliminuar nga punëtori i autorizuar. Punëtoret e shërbimeve kanë kryer pune dhe detyrat tjera sipas kërkesave nga ana e zyrtarëve.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Recepcionisti, ka vazhduar me udhëzimin e palëve në të gjitha Drejtoritë/Zyrat komunale ku janë pajisur me kartela të vizitorëve dhe janë regjistruar në evidencë. Gjatë kësaj periudhe kanë qenë rreth 1950 qytetarë që kanë kërkuar shërbime në drejtoratet komunale vetëm në katin II, të cilët janë pajisur me kartela të vizitorëve dhe janë regjistruar në evidencë. Zyrtari përgjegjës ka udhëzuar palët sipas nevojës gjatë orarit zyrtar, ka dhënë informacione palëve lidhur me kontaktet me zyrtarët, ka evidentuar parregullsitë që vërehen në hyrje-dalje të portës.

VI. Sektori i Arkivit Komunal

Në mbështetje të autorizimeve që i përcaktojnë Ligjet dhe Udhëzimet Administrative të Republikës së Kosovës për sektorin e Arkivit, në gjashtëmujorin e parë kemi kryer punë dhe detyra të punës si në vijim:

Numri i lëndëve që janë kthyer për arkivim në mënyrë fizike dhe elektronike sipas Programeve dhe Drejtorateve.

1. Zyra e Kryetarit të Komunës -----	143
2. Drejtoria për Administratë të Përgjithshme-----	544
3. Drejtoria për Buxhet dhe Financa -----	00
4. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural -----	00
5. Drejtoria për Zhvillim ekonomik -----	25
6. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale -----	190
7. Drejtoria e Arsimit -----	00
8. Drejtoia për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit -----	24
9. Drejtoria për Kadaster, Gjeodezi dhe Pronë-----	01
10. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport -----	00
11. Drejtoria e Inspekcionit -----	225
12. Zyra e Kuvendit -----	27
13. Drejtoia e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë-----	00
14. Zyra për Komunitete dhe Kthim-----	00
15. Drejtorati për Infrastrukturë Lokale -----	39.

Lëndet e arkivuara në mënyrë fizike për gjashtëmujorin Janar-Qershor 2020 janë 1 218; Lëndet e arkivuara në mënyrë elektronike për gjashtëmujorin Janar –Qershor 2020 gjithsejtë për të gjitha programet është 10 895. Dërgimi i listës së zyrtarëve të lartë publik për deklarim të pasurisë në Agjencinë e Kundër Korrupsionit për Komunën e Drenasit [deklarimi i rregullt vjetor], ku në vitin

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

2020 në bazë të ligjeve në fuqi për komunën tonë kanë qenë të obliguar të deklarojnë pasurinë 55 zyrtarë të lartë publik.

2.2. DREJTORIA E ARSIMIT

Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj Drejtorie janë realizuar gjatë kësaj periudhe me përkushtim dhe me përgjegjësi të plotë. Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të njohur dhe të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Drenas. Procesi arsimor gjatë kësaj periudhe ka qenë vazhdimisht i përcjellë me kujdes nga departamenti i drejtorisë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit. Në fund të çdo muaji kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore. Janë mbajtur takime të rregullta edhe me MASHT-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë. Për shkak të pandemisë covid-19, procesi i rregullt mësimor është ndërprerë me 11.03.2020. Mirëpo, DKA-ja edhe gjatë pandemisë ka realizuar takime virtuale të vazhdueshme me të gjithë drejtorët në Komunën e Drenasit dhe ka monitoruar nga afër mbarëvajtjen e mësimit nga distanca.

STRUKTURA ORGANIZATIVE - Këtë sektorë e përbejnë 11 punëtorë: Drejtori, një zyrtar për personel, dy zyrtar për arsim, një pedagog, një psikolog, një zyrtar për financa, një zyrtar për prokurim, një punëtor për lista të pagave dhe arkivim, një zotues, një depoist. Drenasi ka një çerdhe, 29 shkolla fillore dhe të mesme të ultë, 2 paralele të ndara fizike, dy shkolla të mesme, gjithsejtë 34 institucione shkollore, ku punojnë gjithsejtë 957 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt 12194 nxënës. 54 punëtor administrativ, 766 mësimdhënës, 131 punëtor teknik. Çerdhja "Ardhmëria" ka gjithsejtë 125 fëmijë, parafillorë 952 fëmijë, shkollat fillore prej (I-IX) ka gjithsejtë 8398 nxënës, SHML Gjinnazi "Gj.K.Skënderbeu" ka gjithsejtë 1093 nxënës dhe ShMP "Fehmi Lladrovci" ka gjithsejtë 1600 nxënës.

AKTIVITETET DHE DETYRAT E PUNËS - Janë realizuar me sukses mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore në Drenas. Në këto takime kemi kërkuar angazhim edhe më të madh të mësimdhënësve, sidomos në ngritjen e cilësisë në arsim në vitin shkollor 2019-2020, dhe kemi kërkuar respektimin në përpikëri të ligjeve dhe Udhëzimeve të reja Administrative të nxjerra nga MASHT-i. Kemi realizuar takime me prindër, kemi marrë pjesë në manifestimin në Ditën e shkollës në disa shkolla. Gjatë këtij viti nga zyrtarët e arsimit janë vizituar shumë shkolla që kanë kontrolluar mbarëvajtjen e procesit mësimor, kanë mbledhur të dhëna lidhur me zhvillimet e procesit mësimor dhe rezultatet e arritura. Për shkak të pandemisë covid-19, procesi i rregullt mësimorë është ndërprerë me 11.03.2020. Mirëpo DKA-ja edhe gjatë pandemisë ka realizuar takime virtuale të vazhdueshme me të gjithë drejtorët në Komunën e Drenasit dhe ka monitoruar nga afër mbarëvajtjen e mësimit nga distanca. Si DKA në Drenas kemi pranuar raporte të rregullta në baza ditore nga të gjithë drejtoret e shkollave. Interesimi dhe angazhimi i të gjithë akterëve (personelit arsimor, prindërve, nxënësve, stafit mbështetës etj.) ka qenë në nivel ashtu siç është kërkuar në këto rrethana. Si DKA ju kemi bërë të çartë të gjithëve detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e mësimit në distancë konformë udhëzimeve të pranura nga MASHT-i. Gjatë kohës së pandemisë për klasat nga 1-9 mësimi është përcjellë nga transmetuesi publik dhe nëpërmjet platformës emesimi.rks-gov.net që është shfaqur edhe në you-tube. Të gjithë mësimdhënësit i kanë formuar grupet e komunikimit dhe

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISËS LOKALE

kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me prindërit dhe nxënësit, duke e përcjellë angazhimin e nxënësve dhe kryerjen e detyrave. Në nivelin e tretë të shkollimit, klasat 10-12 të arsimit të mesëm të lartë në gjimnazin dhe në shkollën profesionale, në Komunën e Drenasit kemi filluar mbajtjen e mësimit nga distanca nga data 23.03.2020 (në këtë datë ju kemi dërguar kërkesë për konfirmim edhe MASHT-i) dhe tashmë i kemi përfshirë të gjitha lëndët profesionale. Duke filluar nga 06.04.2020 kemi startuar me mësimin e rregullt sipas orarit zyrtar në shkollë. Sigurisht ka qenë sfidë për shkak numrit të madh të lëndëve, mirëpo kemi arritur që të mbajmë me sukses dhe mund të themi se kemi qenë komuna e vetme me këtë formë të organizimit (mbajtjes) së orëve gjatë pandemisë.

DONACIONET - Edhe këtë vit nuk kanë munguar donacionet. Nga MASHT-i është siguruar ndërtimi (planifikimi) i palestrës sportive në në Poklek. Nga MZHE është siguruar renovimi i SHFMU “Dëshmorët e Drenicës” në Vërboc. Kemi siguruar granate nga Banka Botërore në 3 shkolla: SHFMU “Ali Gashi” – Drenas, SHFMU “24 Korriku” në Fushticë, SHFMU “Arif Shala” në Korroticë të Ulët. Nga MASHT-i kemi siguruar donacion në vlerë prej 30.000 euro në SHFMU “Arif Shala” në Korroticë të Ulët. Donacion nga MAPL është edhe ndërtimi i dy shkollave: SHMP në Komoran dhe SHFMU në Fushticë të Epërme, ku është duke vazhduar ndërtimi i tyre në fazat e punimeve të vrazhda.

INVESTIMET KAPITALE - Gjatë këtij viti kalendarik në Drejtorinë e Arsimit, kanë qenë të planifikuara 11 projekte kapitale këtu janë përfshirë disa projekte, mirëpo janë grupuar në mënyrë që të realizojmë më pak shpallje. Nga këto projekte 7 kanë qenë me burimin e fondeve grante qeveritare (10), dhe 2 kanë qenë nga të hyrat vetanake si dhe 2 me kombinimin e të dy burimeve të fondeve (10 dhe 21), mirëpo këto me të hyra vetanake nuk mund të vazhdojnë tutje pa qenë e zotuar vlera e planifikuar në tërësi. Si pasojë e pandemisë, vonesat në alokimin e këtyre fondeve kanë ndikuar në zhvillimin me vonesë të projekteve, sepse nuk ka qenë e mundur të zhvillohen procedura pa qenë mjetet e alokuara. Pasi janë siguruar këto, kemi vazhduar procedurat sipas radhës, ku brenda këtij afat Janar- Qershor, një projekt është i realizuar në tërësi, të tjerat janë në realizim dhe disa nga këto janë në procedurat e prokurimit (në fazën e vlerësimit dhe në fazën shpallje).

Projektet si në vijim **nga grantet (10)**

- I. **Rregullimi i rrethojave të oborreve të shkollave në vlerë (44,298.00€)** – është duke u zhvilluar.
 1. SHFMU “ Zenel Hajdini” Tërstenik I
 2. SHFMU “ 24- Korriku” Fushticë e Poshtme
 3. SHFMU “ Rexhep Gjeli” Likoshan
 4. SHFMU “ 7 Marsi” Kizhnarekë
- II. **Depo për dru dhe thëngjill në këto shkolla dhe vlera kontratës (13,523.80€)** – është lidhur kontrata
 1. SHFMU “Shaban Polluzha” Korroticë e Epërme
 2. SHFMU” Abedin Bujupi” Arllat- Lagja e Xhamisë
 3. SHFMU “Hasan Prishtina” Likoshan
- III. **Riparimi i nxehtësisë qendrore (radiator dhe pajisjeve të tjera përcjellëse në shkolla, vlera e kontratës (7,777.84€)- është realizuar**
- IV. **Furnizimi i shkollave me pajisje të TIK-ut- ky projekt është i përgatitur nga ana jonë, mirëpo është pezulluar nga Agjencioni Qendror i Prokurimit (AQP) për të vazhduar tutje për shpallje.**

RAPORTI I PUNËS JAVAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

- V. **Renovimi i nyjeve sanitare të shkollave** – ky projekt është në fazën e fundit përgatitore, para kalimit në fazat e prokurimit.
- VI. **Inventarizimi i shkollave në Drenas**- ky projekt është në procedurat e prokurimit
- VII. **Renovimi i Objekteve shkollore(kulm dysHEME, dyer dhe dritare)**- ky projekt është në procedurat e prokurimit.

Projektet si në vijim nga të hyrat vetanake

- VIII. **Furnizimi i shkollave me kabinete për Kimi, Fizikë dhe Biologji** – ky projekt është në fazën e vlerësimit.
- IX. **Ndërtimi, rrethimi i fushave sportive** – ky projekt nuk mund të shpallet tani sepse nuk ka mjete të zotuar akoma.

Projektet si në vijim nga grantet (10) dhe nga të hyrat vetanake

- X. **Ndërtimi i platove për rreshtimin e nxënësve** – ky projekt nuk është zhvilluar akoma sepse nuk janë komplet mjetet e zotuar.
- XI. **Ngjyrosja dhe suvatimi i objekteve shkollore** - ky projekt nuk është zhvilluar akoma sepse nuk janë komplet mjetet e zotuar.

KOMUNIKIMI ME MASHT-in - Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar takime të rregullta me MASHT-in, ku kemi dhënë kontributin tonë me nevojat dhe prioritet tona si DKA në sferën e arsimit. Në çdo mbledhje me drejtorë të drejtorive komunale janë paraqitur kërkesat tona dhe gjithashtu janë marrë detyra nga MASHT-i. Kemi dërguar disa kërkesa për përkrahje të cilat janë në proces: Kërkesë për përkrahje në pako për laboratorë (fizike, kimi, biologji), kërkesa për renovime të tualeteve të shkollave, kërkesa për çerdhe, kërkesa për furnizim me inventarë për klasat parafillorë etj.

BASHKËPUNIMI ME BE-në - Gjatë kësaj periudhe, kemi zhvilluar takime me përfaqësuesit e BE-së lidhur me donacionin “Ndërtimi i një Kopshti për fëmijë”, ku pas këtyre bisedimeve ka pasur zhvillime dhe tani jemi në fazën e dizajnit të këtij projekti madhor për Komunën e Drenasit. Po ashtu theksojmë se gjatë kësaj periudhe ka pasur zhvillime ku kemi marr zotime nga ana e kompanisë projektuese që së shpejti do të fillojnë punimet rreth matjeve gjeomekanike në pjesën ku do të ndërtohet objekti, ritheksojmë se ne si drejtori kemi kërkuar nga drejtorit përkatës të largohen të gjitha instalimet që janë pengesë për zhvillimin e projektit (kanalizimi i ujërave të zeza, shtyllat elektrike, instalimet postare), të gjitha këto duhet të largohen në mënyrë që të mos kemi pengesa, vonesa në realizimin e projektit. Ne me kohë pas kërkesës së kompanisë projektuese për largimin e këtyre instalimeve, me kohë kemi larguar të gjitha kabllot, instalimet nga hapësira që është e destinuar për ndërtim të objektit. Kemi marr pëlqimin elektroenergjisë nga KEDS. Janë certifikuar shumica e mësimdhënësve nga projekti i BE-së implementuar nga GIZ-i në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit, trajnimet e mësimdhënësve kanë vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe.

VËSHTIRËSITË – Pandemia ka shkaktuar vështirësi të shumta në të gjitha dimensionet, obligimet financiare që dalin nga implementimi i kontratës kolektive (kërkesa të mëdha për shujta). Gjithashtu kemi kërkuar edhe trajnimin e zyrtarëve të administratës me qëllim të ngritjes profesionale në sektorin përkatës. Staf i profesional na mungon në shumicën e shkollave (sekretar, pedagog, psikolog). Në shumicën e shkollave punët administrative, pedagogjike etj, i kryen drejtori i shkollës.

PËRFUNDIM- Jemi të vetëdijshëm për sfidat që kemi përpara vetës edhe në këtë vit, vetëm e vetëm që në Drenas të ngritet cilësia në arsim, të shtohet disiplina në punë dhe të këtë llogaridhënie

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

në këtë drejtim. Për të krijuar kushte dhe mundësi të reja në rrethanat e reja shtetërore që sot e nesër të kemi shkolla efektive dhe funksionale në kuptimin e plotë, vlen që të gjithë të angazhohemi për ta ngritur sa më lartë cilësinë në arsim. Për këtë kemi krijuar një komision i cili ka për detyrë të skanojë gjendjen në terren dhe të nxjerr rekomandime në funksion të përmirësimit të cilësisë.

2.3. DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Aktivitetet kryesore në gjashtë-mujorin e parë Janar-Qershor 2020	Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë 6 muajve (janar-qershor/2020)
Aktivitetet kulturore	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka realizuar në tërësi plan-programin e vet të punës dhe për periudhën janar-qershor i ka kryer këto aktivitete: - Raporti vjetor i DKRS-së për vitin 2019 - Plani dhe programi i punës për vitin 2020 Aktivitete në Sektorin e Kulturës: - Janë bërë homazhe në Kompleksin e Jasharajve më rastin e 22 vjetorit të sulmit nga forcat serbe ndaj familjes Jashari. - Më rastin e shënimit të 30 vjetorit të rënies së tre dëshmorëve, Enver e Shani Morina dhe Sahit Shala, të rënë në demonstratat e vitit 1990, në sallën e Kulturës, është mbajtur Akademi Përkujtimore. - Manifestimin për 17 shkurtin-Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, filloi duke bërë homazhe tek të gjitha varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në komunën e Drenasit, u mbajt një Seancë Solemne e Kuvendit, u dha një program kulturo-artistik me këngë e valle nga SHKA-të e komunës sonë, pika monologësh nga talentet tanë. Gjithashtu u realizua edhe ndeshja miqësore në mes dy klubeve tona të futbollit (KF “Feronikeli” dhe KF “Drenasi”) dhe për fituesin e kësaj ndeshje u dha kupa e pavarësisë. - Homazhe tek varri i heroit dhe pjesëmarrje në Akademinë Përkujtimore për shënimin e 75-vjetorit të rënies së Heroit të kombit Shaban Polluzha. - Më rastin e shënimit të 22-vjetorit të betejës së Likoshanit dhe Qirezit, janë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Likoshan dhe Qirez dhe është bërë zbulimi i Pllakës Përkujtimore të Mehmet dhe Naser Gjeli, po ashtu Pllaka Përkujtimore është zbuluar edhe në kullën e Ibrahim Rexhepit. - Më rastin e shënimit të 22 vjetorit të “Epopesë së UÇK-së”, rënies heroike të Familjes Jashari dhe Komandantit Legjendar, Adem Jashari, kemi bërë homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, në Kompleksin Memorial të

RAPORTI I PUNËS JAAAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISSES LOKALE

Dëshmorëve në Marinë dhe në Sheshin “Fehmi Lladrovci” në Drenas pranë shtatorëve të Shaban, Hamëz e Adem Jashari. Në shënim të këtij përvjetori është mbajtur edhe Seancë Solemne e përbashkët e dy Kuvendeve Komunale Drenas dhe Skenderaj;

- Më rastin e shënimit të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, është mbajtur mbledhje solemne.
- Si DKRS në respektim të vendimeve të qeverisë dhe masave tjera mbrojtëse të rekomanduara nga OBSH dhe IKSHPK, për parandalim të përhapjes së pandemisë COVID-19, jemi obliguar të ndërpresim dhe pezullojmë të gjitha aktivitetet kulturore, sportive dhe Rinor;
- Janë bërë homazhe me rastin e 21 vjetorit të rënies së heroit të kombit Ilaz Kodra, 40 dëshmorëve dhe 275 martirëve;
- Janë bërë homazhe me rastin e 21 vjetorit të rënies së heronjve Rasim Kiqina e Ragip Halilaj, pranë shtatores së heroit Rasim Kiqina në sheshin “Fehmi Lladrovci” dhe në Kompleksin Memorial në Marinë.
- Me rastin e shënimit të 21 Vjetorit të Ditës së Çlirimit, qyteti ynë u dekorua me flamuj dhe bilborda me mbishkrim me 11.06.2020 ndërsa me 14.06.2020 u mbajt Seancë Solemne e Kuvendit Komunal për të vazhduar me homazhe te shtatoret e heronjve në sheshin “Fehmi Lladrovci”, Komplekset Memoriale në Prekaz dhe Marinë si dhe homazhe tek të gjitha vendvarrezat e dëshmorëve në komunën tonë (për shkak të situatës pandemike nuk është mbajtur ndonjë aktivitet tjetër festiv);
- Nga momenti i krijimit të gjendjes pandemike, në respektim të masave mbrojtës dhe rekomandimeve të institucioneve kompetente, kemi mundur mbajtjen e seancave të Kuvendit Komunal në Sallën e Kulturës;
- Pjesëmarrje në fillimin e punimeve për konservimin dhe restaurimin e shtëpisë së Fadil Muqollit ku kishte ndodhur masakra e Pokleikut, ku ishin vrarë e djegur 53 shqiptarë civil, ndër ta 23 fëmijë.
- Me kërkesë të DKRS-ës kemi arritur të pasurojmë fondin e bibliotekave tona libra të rijnë të cilat i dhuruan:

Biblioteka “Hizi Sulejmani” Prishtinë	611	2020
Libraria “Dukagjini”	434	2020

Arkivi komunal:

- Janë lëshuar 2 Certifikata shkollore për palë,
- Një palë – Studente ka punuar për disa ditë në hulumtimin e të dhënave në historiatet e fondeve arkivore për punim të temës së diplomës për Master;
- Pranimin e 2 kërkesave në mënyrë elektronike përmes emailit zyrtar, kthimin e përgjigjeve në mënyrë elektronike së bashku me lëndët e bashkangjitura,
- Pranimin e dy kërkesave nga zyrtarët e komunës (të drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe drejtoria për Urbanizëm);
- Vizitë në SHFMU “ Rasim Kiqina” për të parë gjendjen e lëndës arkivore,

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

	- Evidentimin, Skanimin e Librit të Amzës nr. 4. Të fondit nr. 3 të shkollës fillore “Jeta e Re “ të Komoranit; - Përpunimin e lëndëve të Drejtoria për Urbanizëm bartjen e shënimeve të skanuara të fondit nr. 48 të drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor dhe ruajtjen në CD, (Kontrata, Vendime Kopje të planeve etj.); - Përpunimin, Skanimin e 149 lëndëve të ndryshme të fondeve arkivore, Përpunimin, rregullimin, sistemimin e lëndëve me projekte të ndryshme të viteve 1977 – 1998; - Në bashkëpunim me zyrtarin e projekteve nga DKA kemi bërë përgatitjen e paramasave për renovimin e depos dhe zyrës së Arkivit. - Skanimin e vendimeve për shkollat fillore : “Naim Frashëri” fsh. Glllobar dhe shkollës fillore “Fazli Grajqevci” Poglek-Vasilevë, - Një kërkesë përmes emailit zyrtar i kemi dërguar zyrtares së drejtoria për urbanizëm (Flora Krasniqi) për kthimin e 2 lëndëve origjinale që i ka marrë në Arkiv (një dosje për objektin e Feronikelit dhe një Hartë sipas Aza Demakut që ia ka dorëzuar), - Pranimin e një shkrese nga QPFSH për promovimin e turizmit ne regjionin e Prishtinës, lidhur me produktet artizanale në komunën e Drenasit, komunikimin me zyrtarët e DZHE-së për të gjetur listën e operatorëve që ushtrojnë këtë veprimtari, vizitë në teren për grumbullimin e të dhënave për ushtrimin e veprimtarive artizanale për të grumbulluar të dhënat për veshjet tradicionale, dërgimin e materialit për të promovuar turizmin në regjionin e Prishtinës. - 3 vendime të pranuar nga Zyra e Prokurimit për pjesëmarrje ne komisione të ndryshme të vlerësimit të tenderëve, - Pranimin e materialeve të ndryshme për DKRS, - Përgatitjen e raportit javor të sektorëve për DKRS - 4 Vizita janë bërë monumenteve të Trashëgimisë Kulturore Arkitekture, Arkeologjike (Mullirit të Jashar S. Gjokës, Kalanë e Vuçakut , Shtëpi banimi Rexhep Zariqit, Mulliri i Bajram Ali Gashit) - Kontrollimin e listave të përfituesve të OJQ-ve Kulturore, sportive për vitet 2018, 2019 dhe plotësimin e të dhënave për DKRS. Përgatitjen e raportit përfundimtar për 4 OJQ-të kulturore dhe 2 individ, përfitues të Subvencioneve nga DKRS, dërgimin e raportit DKRS-së, - Përpunimin e lëndëve të mbetura në proces të Intranetit të drejtuar për DKRS – në dhënien e statusit të tyre për vitin 2020 përgatitjen e kërkesave për DKRS për blerje, zotim, përgatitjen e raporteve për pranim nga komisioni dhe kryerje të shërbimeve për DKRS (Janar, Shkurt). - Në bashkëpunim me zyrtarin e sektorit të sportit kemi plotësuar formularin me të dhënat për OJQ-të, vendosjen ne tabela te dërguara nga Drejtoria e Financave dhe publikuar në ëeb-faqen e Komunës, - Grumbullimin e të dhënave për monumentet e Trashëgimisë Kulturore për Kalanë e Vuçakut, Kalanë e Vërbocit, Mullirin e Gani Sylës në Kishnarekë, Kullën e Habib Xhemajl Agës në fshatin Dritan, Gurin e Plakës monument i trashëgimisë Natyrore
--	--

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

	përgatitjen e shënimeve për t'i dërguar QKRMT-së për të përgatitur fletëpalosjen turistike në kuadër të regjionit të Prishtinës. - Takim me grupin punues plotësimin e tabelave për Trashëgimi Kulturor dhe Turizëm dhe takim me qytetarët për PZHK dhe PZHU prezantimin e Draft projektit 2020 – 2028; - Takim pune me komisionin për konkursin e shpallur për marrëveshjet e shërbimeve të veçanta, - Pjesëmarrje në Sesionin Informues Projekti -“NEËBORN” mbi promovimin e Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturor në regjionin e Prishtinës i organizuar nga Regional Cooperation Council për dy ditë radhazi. Bibliotekat në Komunën e Drenas gjatë kësaj periudhe ka regjistruar dhe ka pasur lexues për gjysemvjetorin e parë të vitit-2020. <table><tr><th>Muaji-Janar-Qershor 2020</th><th>Nr. i ekzemp.</th><th>Nr i titujve</th><th>Ekzemplar të ri</th><th>Libra të lexuara</th><th>Nr. i lexuesve</th><th>Lexues të ri</th><th>Gjithsëj lexues</th></tr><tr><td>Drenas</td><td>7750</td><td>2847</td><td>753</td><td>1226</td><td>162</td><td>57</td><td>404</td></tr><tr><td>Terstenik</td><td>4229</td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>Arllat</td><td>5134</td><td>935</td><td>134</td><td>479</td><td>362</td><td>4</td><td>106</td></tr><tr><td>Komaran</td><td>3180</td><td>1823</td><td>158</td><td>306</td><td>178</td><td>37</td><td>178</td></tr><tr><td>TOTALI</td><td>20293</td><td>5605</td><td>1045</td><td>2011</td><td>702</td><td>98</td><td>688</td></tr></table>	Muaji-Janar-Qershor 2020	Nr. i ekzemp.	Nr i titujve	Ekzemplar të ri	Libra të lexuara	Nr. i lexuesve	Lexues të ri	Gjithsëj lexues	Drenas	7750	2847	753	1226	162	57	404	Terstenik	4229							Arllat	5134	935	134	479	362	4	106	Komaran	3180	1823	158	306	178	37	178	TOTALI	20293	5605	1045	2011	702	98	688
Muaji-Janar-Qershor 2020	Nr. i ekzemp.	Nr i titujve	Ekzemplar të ri	Libra të lexuara	Nr. i lexuesve	Lexues të ri	Gjithsëj lexues																																										
Drenas	7750	2847	753	1226	162	57	404																																										
Terstenik	4229																																																
Arllat	5134	935	134	479	362	4	106																																										
Komaran	3180	1823	158	306	178	37	178																																										
TOTALI	20293	5605	1045	2011	702	98	688																																										
Aktivitetet sportive	Spektori i Sportit e ka realizuar plan-programin e vetë të punës dhe për periudhën janar-qershor ka zhvilluar këto aktivitete. Në kuadër të planifikimit të punëve dhe aktiviteteve të zhvilluara në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, përkatësisht Spektorit të Sportit janë kryer këto punë – aktivitete sportive: - Janë zhvilluar takime me klubet dhe shoqatat sportive për plotësimin e dokumentacionit/formularëve dhe raportimit për subvencionimin e aktiviteteve sportive, - Pjesëmarrje në komisione të ndryshme në bazë të vendimit të kryetarit të komunës,																																																

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISËS LOKALE

	- Kemi bashkëpunuar edhe me Drejtorinë të Arsimit për koordinimin për aktivitetin për shënimin e ditës Ndërkombëtare Olimpike si dhe garat e Shfmu-ve dhe Shml-ve, - Në muajin mars janë zhvilluar garat në Hendboll, për Shfmu-të dhe Shml-të me ç’ rast për fituesit janë ndarë shpërblime dhe mirënjohje; - Janë ndihmuar klubet në transportin e lojtarëve të klubeve për zhvillimin e lojërave kampionale, - Me mbështetjen teknike të ofruar nga ne është realizuar pjesëmarrja e çiklistëve tanë në aktivitetin “Me një biçikletë s’ vjen vera” organizuar nga Federata e Çiklizmit e Kosovës; - Në palestrën sportive „Hysni Jetullahu” me datë 23.02.2020 u mbajt aktiviteti sportiv Kupa e Pavarësisë 2020-Indor nga Federata e Shigjetarisë së Kosovës, - Janë mbajtur disa takime të kuvendeve të klubeve sportive; - Është renovuar kulmi i objektit të stadiumit sintetik, pas dëmit të shkaktuar nga fatkeqësia natyrore (erërat e forta); - Janë mbikëqyrë fushat sportive (Komoran, Polluzhë dhe Damanek); - Si organ mbikëqyrës është bërë raporti për pagesën në projektin „Dekorimi i Qytetit”, - Është bërë pastrimi dhe dezinfektimi i objekteve sportive, Stadiumit Sintetik dhe Palestrës Sportive, si dhe janë pastruar hapësirat jashtë, është kositur bari si dhe në palestrën “Hysni Jetullahu” janë mbjellë drunjtë gjethembajtës; - Pjesëmarrje e zyrtarit të sportit në komisionet vlerësuese të ofertave për projektet e ndryshme në Drenas, në bazë të vendimit të zyrës së prokurimit, - Është hartuar raporti në bazë të vendimit të kryetarit për monitorimin dhe implementimit të projektit për subvencionimit të klubeve tona, - Në bashkëpunim me KOK është zhvilluar aktiviteti sportiv me fëmijët e lindur në vitin 2008 për shënimin e Ditës Ndërkombëtare Olimpike dhe kështu videoja e shënimit të këtij aktiviteti nga KOK-u u vlerësua me vendin e gjashtë në garë e të gjitha komunave; - Janë bërë përgatitjet për themelimin e klubeve të reja sportive në sportet e Çiklizmit, Karatesë; Stadiumi Sintetik – Drenas Raporti gjashtë mujor Janar-Qershor - Më datën 14.03.2020, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, në respektim të vendimeve të Qeveris së Kosovës, si masë parandaluese ndaj përhapjes së virusit COVID-19, jemi njoftuar për ndërprerje të të gjitha aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore, në objektin sportive publik. Ky njoftim ka qenë i vlefshëm deri me 22.06.2020, ndërsa pas kësaj date jemi njoftuar se në fazën e III të lehtësimit të masave qeveritare, lejohet zhvillimi i aktiviteteve sportive duke respektuar disa
--	--

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISSES LOKALE

	Muaj	Stërvitjet	Orë	Nr. i Lojtarëve	Nr. i shikuesve	Ndeshje Kampionale
1.	Janar	117	144.45	3183	1042	7
2.	Shkurt	157	201.20	4758	1594	26
3.	Mars	87	111.10	2536	796	11
4.	Prill	Ndërpriten të gjitha aktivitetet si masë parandaluese ndaj Virusit COVID-19				
5.	Maj	Ndërpriten të gjitha aktivitetet si masë parandaluese ndaj Virusit COVID-19				
6.	Qershor	42	57.30	934		
	Përmbledhje e aktiviteteve	403	514.45	11411	3432	44
	Dëmet në Objekt	Pas dëmit të shkaktuar nga fatkeqësia natyrore erërat e forta është dëmtuar dhe është renovuar një pjesë e kulmit të Objektit të Stadiumit Sintetik.				

prej masave mbrojtëse të specifikuar Manualit për Mbrojtje nga Përhapja e Virusit COVID-19;

- Është dezinfektuar objekti, janë vendosur dezinfektues dhe mbishkrime për respektim të masave mbrojtëse në vende të qasshme në objekt;
- Janë lejuar aktiviteteve stërvitore dhe ndeshjeve përkatësisht për klubet e futbollit të Superliges. është lejuar mbajtjen e aktiviteteve stërvitore për klubin e KF "Feronikeli" dhe KFF "Feronikeli". Njoftimi i radhës nga DKRS, që objektet sportive mund të shfrytëzohen nga data 22.06.2020. Klubet janë përgjegjës për marrjen e të gjitha masave mbrojtëse dhe zbatimin e manualit për mbrojtje nga Përhapja e Virusit COVID-19,
- Kemi forcuar e drejtuar shtyllat e rrethojës;
- Kemi pastruar brena dhe hapësirat për rreth objektit të Stadiumit Sintetik,
- Janë pastruar dhe kositur hapësirat e gjelbra tek Objekti i Qendrës Kulturore për Gruan;

Palestra e Sportit "Hysni Jetullahu" – Drenas
Raporti gjashtë mujor Janar-Qershor

Nr	Muaj	Stërvitjet	Orë	Nr. i Lojtarëve	Nr. i shikuesve	Ndeshje Kampionale
1.	Janar	31	51	386	-	-
2.	Shkurt	80	124	1257	30	1
3.	Mars	55	98	1144	310	6

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

	4.	Prill	Ndërpriten të gjitha aktivitetet si masë parandaluese ndaj Virusit COVID-19				
	5.	Maj	Ndërpriten të gjitha aktivitetet si masë parandaluese ndaj Virusit COVID-19				
	6.	Qershor	7	14	81	80	2
		Përmbledhje e aktiviteteve	173	287	2868	420	9
		Dëmet në Objekt	Nuk ka dëme në këtë periudhë				
Aktivitetet rinore	Sektori i Rinisë në bashkëpunim me KVRL-në gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar këto aktivitete: - Realizimi i sesionit informues në lidhje me punëtorinë “Podium” e cila do të realizohet me përkrahje të Peer Education Netëork-PEN, ky aktivitet ka për qëllim zhvillimin e aftësive për avokim dhe lobim të adoleshentëve në mënyrë që ata të mund të përmirësojnë kushtet e komuniteteve ku ata jetojnë; - Është mbajtur sesion informues për punëtorinë UP-Shift; - Në bashkëpunim me të Rininë Aktive të Gjakovës dhe financim të GIZ-it, është realizuar trajnimi i cili ka për qëllim t’i aftësojë të rinjtë që të shkruajnë saktë CV-në, letrën motivuese si dhe përgatitja e tyre për një intervistë pune; - Me tu shpallur gjendje emergjente e shëndetit publik pas përhapjes së pandemisë COVID në shtetin tonë, kemi realizuar një fushatë sensibilizuese për vetëdijesim të qytetarëve që ata të respektojnë rekomandimet e institucioneve relevante që trajtojnë pandeminë; - Në bashkëpunim me vullnetaren amerikane e cila për shkak të pandemisë ka shkuar në Amerikë, në formë virtuale kemi realizuar ligjëratën online me temën “Lidershipi dhe strategjia si të qëndrojmë në shëndetshëm në shtëpi” e cila ka qenë e qasshme për të gjithë të rinjtë; - Realizimi i takimeve online me strukturat e KVRL-ës;						
Projektet kapitale	Në kuadër të projekteve kapitale në gjashtëmujorin e parë të 2020 kemi pasur pengesa në realizimin e tyre për shkak të pandemisë, por prapë ka pasur zhvillim të punimeve kështu kemi këto projekte të zhvilluara në këtë periudhë: - Vazhdimi i ndërtimit të Stadiumit “Rexhep Rexhepi” faza e dytë; - Vazhdimi i projektit të Renovimit dhe Inventarizimit Qendrës Rinore; - Renovimi i pjesshëm i kulmit të Stadiumit Sintetik, si projekt kapital emergjent;						

RAPORTI I PURËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Ndarja e subvencioneve 2020	Gjatë kësaj periudhe janë subvencionuar OJQ-kulturore, sportive, rinore dhe individ:		
	MJETE TË NDARA PËR AKTIVITETE KULTURORE-2020		
	Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik	Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteve të financuara	Shuma e dhënë (Euro)
	ShKA "Shote Galica"	Mbështetje financiare për aktivitetin e SHKA "Shote Galica"	2000 €
	OJQ “Shqipet e Drenicës”	Mbështetje financiare për aktivitetin e OJQ “Shqipet e Drenicës”	2500 €
	SHKA “Komorani”	Mbështetje financiare për SHKA “Komorani”	500 €
	Nuredin Ibriqaj	Mbështetje financiare për botimin e monografisë	500 €
	Genc Heta	Mbështetje Financiare për shfaqje teatrale	700 €
	Shkumbin Veseli	Mbështetje financiare për promovim te kulturës rurale	700 €
	Elhami Gjeli	Mbështetje financiare për realizimin e një filmi të shkurtër	1000 €
	Albert Sinani	Mbështetje financiare për ekspozitë me fotografi	1000 €
	MJETE TË NDARA PËR AKTIVITETET RINORE-2020		
MJETE TË NDARA PËR AKTIVITETE SPORTIVE-2020			

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik	Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteteve të financuara	Shuma e dhënë (Euro)
OJQ Këshilli i veprimit rinor lokal në Drenas	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve rinore	3000
Emri i OJQ-së përfituese, dhe personave fizik	Emri i projektit dhe /ose programit apo aktiviteteve të financuara	Shuma e dhënë (Euro)
KF "Feronikeli"	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	40000 €
KH "Drenica" (M)	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	8000 €
KV "Feronikeli" (F)	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	2000 €
Klubi i Shigjetarisë "Feronikeli"	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	1000 €
KF "Drenasi"	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	6000 €
KB "Feronikeli"	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	6200 €
Klubi i Ngjithjes Ketrat	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	1000 €
"Shoqata e të Shurdhërve"	Mbështetje për aktivitetin e Shoqatës së Shurdhërve	500 €
Neë Stars Soccer School	Mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve sportive	300 €

Objektivat e DKRS-së për gjashtë mujorin e dytë të vitit-2020, nëse kemi përmirësim të situatës pandemike janë:

- Realizimi i Muajt i Mërgatës;
- Shënimi i aktiviteteve Ditët e Rinisë;
- Ditët e Humorit Drenas;
- Realizimi i projekteve të financuara/subvencionuara nga DKRS;

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

- Shënimi i festave e Nëntorit;
- Shënimi i aktivitetit "Kongresi i Manastirit"
- Shënimi i aktiviteteve sportive të planifikuara në Planin Vjetor të Punës.

2.4. DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL (DBPZHR)

Drejtorja për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në kuadër të kompetencave, autorizimeve dhe përgjegjësisë të saj funksionon në zbatim të drejtpërdrejtë të ligjeve :

- ✓ Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L-26 ;
- ✓ Ligji për mbrojtjen e bimëve Nr. 02/L-95 ;
- ✓ Ligji për shërbime këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr.04/L-74 ;
- ✓ Ligji për Gjuetinë Nr.02/L-53;
- ✓ Ligji për Bletarinë Nr.03/L-111 ;
- ✓ Ligji për kujdesjen ndaj kafshëve Nr.02/L-10 ;
- ✓ Ligji për pyjet e Kosovës Nr.2000/3 ;
- ✓ Ligji 03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.2003/3 për pyjet e Kosovës

Sektori për Bujqësi dhe Zhvillim rural ka kryer këto punë:

- Janë dhënë Këshilla direkte për fermerë në të gjithë sektorët e bujqësisë,
- Regjistrimi i fermerëve të ri në regjistrin e fermës,
- Janë lëshuar certifikata të fermerëve (NIF-i dhe ANEKS-i),
- Shpërndarja e broshurave për fermerë në të gjithë sektorët e bujqësisë,
- Pranimi, shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të fermerëve dhe kthimi i përgjigjeve,
- Gjatë kohës së kufizimit të lëvizjes së lirë për shkak të Pandemisë Covid-19 i kemi pajisur 190 fermer me vërtetim të lëvizjes së lirë,
- Është përfunduar raporti vjetor i Sektorit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2019,
- Përgatitja e Projekteve të Propozuara për vitin 2020 nga DBPZHR,
- Është bërë planifikimi dhe realizimi i të mbjellurave pranverore për vitin 2020 dhe është përcjellë në MBPZHR,
- Punim në kërkesa fillestare për ndarjen e mjeteve financiare të projekteve për vitin 2021-2023,
- Furnizimi me pajisje mbrojtëse kundër COVID-19,
- Furnizimi me material shpenzues (letër) për DBPZHR,
- Kërkesat për zotim të pagave për punëtorët me Kontratë për Marrëveshje me Shërbime të Veçanta,
- Kërkesat për zotim të mjeteve dhe raportet për pagesë të faturave të ndryshme të DBPZHR-së,
- Punime në Komisione të ndryshme Komunale (Dalje në teren, përgatitje të raporteve, dorëzime të lëndëve),
- Punimi dhe Kompletimi i lëndës për rishpalljen e tenderit për dhënien me qera të gjahishtës "Drenica",

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISIES LOKALE

- Nxjerrja e statistikave rreth tokave Bujqësore në Komunën tonë dhe punim i statistikave në sektorët e Bletarisë dhe në Perimkulturë – sipërfaqet e mbjella në ambiente të mbyllura (serra) në Komunën tonë,
- Përgatitja e raporteve mujore dhe dërgimi në Qendrën Informuese Këshilluese “QIK” ,
- Është bërë përcjellja e të dhënave për Bankën Botërore për sipërfaqet të mbjellura me pemë (mollë, kumbull) mbi 2 ha si dhe pemë të imta (dredhëz) mbi 1 ha për arsye të implementimit të projektit për Sigurime Bujqësore,
- Punime në plotësimin e të dhënave për integritetin dhe menaxhimin e rreziqeve për TM4 /2019,
- Punime në plotësimin e formularit për financimin e OJQ-ve për vitin 2019,
- Punime për plotësimin e formularit për agjencinë për barazi gjinore për gratë përfituese të subvencioneve nga komuna nga viti 2014–2019,
- Plotësim i formularit – Studim mbi Ndikimin Socio-Ekonomik të COVID -19,
- Është bërë dalja në teren me inspektorët e AUV për marrjen e mostrave të farës së misrit me sipërfaqe prej 20 ha (dështimi i mbishmërisë),
- Vizita tek fermerët e komunës sonë,
- Azhurnimi i lëndëve në mënyrë elektronike në kuadër të DBPZHR-së.

Sektori i pylltarisë gjatë kësaj periudhe ka kryer këto punë:

- Në gjykatë janë ngritur 12 fletëparaqitje prej tyre 10 janë penale dhe 2 kundërvajtëse
- Seanca gjyqësore janë mbajtur gjithsejtë 6, prej tyre 4 të karakterit penal dhe 2 kundërvajtës.
- Vendime të shqyrtuara nga gjykata janë gjithsejtë 7 lëndë (të gjitha janë penale dhe të shqyrtuara)
- Janë konfiskuar 3.76m³ dru transport ilegal
- Ka pasur dy zjarre në pyje publike me intensitet të dobët në sipërfaqe 0.30ha.
- Damkim në pyje shtetërore në objektin e “Pallanikut” në Berishë për shitje me pakicë si dhe vlerësim i masës drunore për zgjerimin e rrugës në Berishë deri tek Kisha në Llapushnik.
- Kemi pranuar 7 kërkesa për prerje në pyje private dhe janë përcjellë për shqyrtim në Drejtorinë Koordinuese në Prishtinë.
- Inspektive pyjore janë kryer gjithsejtë 10.
- Janë kryer dy kontrole të tregut në bashkëpunim me policinë dhe inspektorët komunal.
- Të hyra nga taksa në pyje private kemi 500 euro.
- Lëndë të dërguara te përmbaruesi kemi gjithsejtë 25 copë
- Lëndë të dërguara në gjykatë kemi gjithsejtë 20 copë.

➤ Trajnime dhe Projekte nga MBPZHR

- Është bërë thirrja Publike, Aplikimi, Kompletimi dhe Dorëzimi në AZHB i lëndëve për pagesat direkte qumësht/litër sipas cilësisë dhe therjet e raportuara të gjedhit për gjashtëmujorin e dytë 2019,
- Me kërkesë të MBPZHR është bërë vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në bujqësi gjatë kohës së pandemisë COVID-19 (në mungesë të tregut),

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

- Trajnim i organizuar nga MBPZHR-ja në bashkëpunim me Projektin AGRO që mbështetet nga USAID trajnimi ka pasur karakter të ngritjes së kapaciteteve të këshilltarëve publik për përgatitjen e projekteve nga donatorët e ndryshëm,
- Trajnim në USAID i organizuar nga MBPZHR, DSHKT, DPBT në bashkëpunim me projektin AGRO të mbështetur nga USAID me temën : Standardet e Sigurisë së Ushqimit dhe vlerësimin Mjedisorë në Bujqësi,
- Trajnim për inspektorët dhe fermerët lidhur me raportimin (Njoftimi për lëvizjen e kafshëve dhe rastet e sëmundjeve të tyre)
- Trajnim nga MBPZHR –ja: Moduli i parë (29-30.06.2020)–Teknologjitë e Avancuara në Prodhimtarinë Bujqësore,
- Pjesëmarrje në takimin e punëtorisë së organizuar nga Qendra Grumbulluese e fruta-perimeve “Agrocelina,, dhe barnatorja bujqësore “Agronomi” në Rahovec për kultivimin e trangujve Kornishon nga fara hibride e prodhuar nga kompania holandeze Rijk-Zëann.
- Trajtime dhe Projekte nga IADK dhe ESG :
- Është mbajtur konferenca në Prishtinë me IADK – në me temën : Përvojat dhe Sfidat në prodhimtarinë e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike,
- Në bashkëpunim me IADK-në është bërë Shpallja Publike , Sësoni informues dhe Trajtime me fermerë aplikues për Grande në BMA dhe të Riatdhesuar,
- Është bërë Aplikimi, Pranimi dhe Dorëzimi i dokumentacioneve të fermerëve aplikues në projektet : BMA dhe të Riatdhesuar nga IADK,
- Në bashkëpunim me IADK –në është bërë përzgjedhja dhe nënshkrimi i kontratave me fermerët përfitues në projektet BMA dhe të Riatdhesuar,
- Në bashkëpunim me Zyrën Komunale për Komunitet dhe Kthim, IADK-së ju kemi dërguar vërtetimin e kërkuar me të cilin konfirmohet që përfituesit e përzgjedhur në projektin për të riatdhesuar nuk kanë qenë përfitues të mëhershëm në ndonjë projekt të ngjashëm,
- Trajnim praktik i organizuar nga IADK me pemëtarët e Komunës sonë Demonstrimi Praktik – Krasitja Dimërore në Pemishte – Vërboc,
- Me kërkesë të kompanisë konsultative ESG-së janë përcaktuar fermerët për marrjen e mostrave të dheut në parcela me kultura të ndryshme.

2.5. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2020 janë bërë inspektive sipas lëmive përkatëse inspektuese duke filluar nga shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve në të gjithë sektorë, inspektive në terren sipas detyrave dhe agjendës ditore për secilin sektor të përcaktuar nga inspektorët se bashku me stafin udhëheqës të Drejtorisë. Që nga fillimi i paraqitjes së rasteve të para të virusit Covid-19 në Kosovë, Drejtoria e Inspektionit në bashkëpunim dhe asistim të Policisë së Kosovës, sipas Ligjit nr.02/1-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, Manualit dhe rekomandimeve të IKShP, ka bërë inspektive dhe kontrole të përgjithshme nëpër të gjitha subjektet afariste dhe institucioneve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Kryesisht është bërë mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve të Qeverisë së Kosovës, Vendimit të Kryetarit të Komunës, Ligjit për Tregti të Brendshme, Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës dhe Ligjeve tjera në fuqi.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISËS LOKALE

Sektori Sanitar

Inspektori sanitar ka bërë inspektimin e subjekteve aktive në territorin e Komunës së Drenasit duke përfshirë ato ushqimore (marketet, furrat e bukës dhe restaurantet me shërbim delivery), ku në përgjithësi janë marrë masat e sigurisë sipas rekomandimeve dhe vendimeve në fuqi. Në këtë periudhë është vazhduar me inspektimin e subjekteve afariste hoteliere rreth kontrolles së Ligjit për duhanit. Gjithashtu, është bërë kontroll e institucioneve arsimore rreth kushteve higjienike dhe sanitare, sidomos në ato shkolla ku është hasur në parregullsi në inspektimet e kaluara. Gjithashtu janë shqyrtuar kërkesat e Institucioneve arsimore private dhe publike për marrjen e pëlqimit sanitar rreth kushteve higjienike dhe sanitare.

Drejtoria e Inspektionit në bashkëpunim dhe asistimin e PK sipas Ligjit nr.02/1-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, manualit dhe rekomandimeve të IKShP dhe Vendimit të MEPTINS ju është ndaluar ushtrimi i veprimtarive të subjekteve afariste sipas kodeve të veçanta, e të cilat janë mbyllur me shenjë zyrtare nga ana e inspektoratit komunal. Pas hapjes së salloneve të ondulimit me vendimin e datës 18.05.2020 është bërë mbikëqyrja e kushteve të punës dhe masat për mbrojtje ndaj pandemisë. Të gjitha subjektet të cilat janë hapur ju është dhënë Urdhëresa për zbatimin e të gjitha masave të rekomanduara ndaj COVID-19 dhe inspektimet ende janë duke vazhduar. Kemi vazhduar me mbikëqyrjen e respektimit të orarit të lëvizës së qytetarëve, numrin e pasagjerëve në veturë dhe ndalesa të tjera të caktuar me këtë vendim. Personat që janë ndaluar janë evidentuar me procesverbal dhe u është tërhequr vërejtja, që në rast të përsëritjes së shkeljes do të merren masat ndëshkuese ndaj tyre. Inspektori sanitar në bashkëpunim dhe sipas njoftimeve të Drejtorisë së Shëndetësisë ka filluar me lëshimin e Aktvendimeve për vetëkarantinim (vetëizolim) të personave të prekur me COVID-19, ku janë lëshuar 19 aktvendime dhe 2 anulime.

Sektori i Tregut

Inspektorët kanë realizuar kontroll në të gjitha subjektet afariste, ku rëndësi të veçantë i është kushtuar inspektimit të marketeve ushqimore, furrave të bukës, shërbimeve të subjekteve të gastronomisë dhe tjerave rreth deklaracionit të mallit, çmimeve, zbatimit të orarit të punës, certifikatave të biznesit, licencave etj. Inspektim i bizneseve sipas regjistrimit të DZHE, mbarëvajtja e tregut, inspektim i bizneseve të cilat kanë ekspozuar artikujt jashtë lokali. Gjithashtu, është bërë shqyrtimi i kërkesave për dhënie e pëlqimit për ushtrimin e veprimtarisë. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, kryesisht është bërë mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve të Qeverisë, Vendimit të Kryetarit të Komunës, Ligjit për Tregti të Brendshme, Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës dhe Rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Inspektorët e tregut në bashkëpunimin me zyrtarët policor, kanë realizuar numër të madh të inspektimeve gjatë dhe pas orarit të punës, në zbatim të masave dhe vendimeve të nivelit qendror dhe lokal për mbrojtje nga virusi.

Sektori i Komunikacionit

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2020 është inspektuar në lëmin e transportit të udhëtarëve sipas Ligjit për Transportin Rrugor Nr.04/L179 dhe në bazë të Rregulloreve të Komunes së Drenasit Nr.06/7086 dhe 12 Nr.344-50040. Janë inspektuar të gjitha kompanitë e licencuara për transportin e udhëtarëve, respektimi i rendit të udhëtimit, Stacioni i Autobusëve, respektimi i peronizimit, veçanërisht operatorët transportues në linjën ndërrbane Skenderaj-Drenas-Prishtinë, ku janë detyruar që të hyjnë në Stacionin e Autobusave në Drenas. Për shkak të pandemisë dhe angazhimit intensiv të gjithë inspektorëve në zbatim të masave ndaj virusit, inspektimet për ndalimin e veprimtarisë së taksive ilegale janë në numër më të vogël në këtë gjashtëmujor.

Spektori i Ndërtimit

Gjatë kësaj periudhe janë bërë inspektime të ndryshme në lëmin e ndërtimit bazuar në Ligjin për Ndërtim nr. 04/L-110, Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe në Ligjin për Inspektoratin, si dhe udhëzimet përkatëse administrative. Inspektimi i kryer ka qenë në dy forma: Inspektim i rregullt (me kërkesë të palës apo poseduesit të lejes ndërtimore) dhe Inspektim pa paralajmërim në rast të dyshimit të inspektorit ose në rast të ankesës nga një palë e tretë. Inspektimi i rregullt është kryer me kërkesë të poseduesve të lejeve ndërtimore për të mbikëqyrë punimet në faza të ndërtimit. Gjatë inspektimit të punimeve është kontrolluar kualiteti i punimeve, respektimi i standardeve, përputhja e ndërtimit me lejen ndërtimore, përputhja e ndërtimit me dokumentacionin ndërtimore (projektin kryesor të aprovuar nga organi kompetent) Rëndësi e veçantë i është kushtuar vendosjes së objektit (ndërtimit) në lokacionin e paraparë me projektin e aprovuar.

Inspektimi i jashtëzakonshëm është bërë në bazë të dyshimeve të inspektorit se punimet zhvillohen jashtëligjshëm duke shkelur ligjin e ndërtimit përkatësisht pa leje ndërtimore dhe rrjedhimisht pa inspektim të punimeve. Në këto raste është urdhëruar ndërprerja e punimeve menjëherë me procesverbal, janë larguar punëtorët nga vend ndërtimi dhe është vendosur shenja zyrtare (shiriti) për pengimin e zhvillimit të mëtejshëm të punimeve, si dhe u është dhënë afat për të aplikuar për leje ndërtimore. Gjatë inspektimeve, përkatësisht gjatë ndërprerjes së punimeve pa leje ndërtimore është kërkuar asistencë e Policisë së Kosovës. Inspektimi i të gjitha objekteve është përqendruar në zonat urbane, në pronë komunale, në tokat në masën komosative, në brezin rrugor dhe objekte të kategorisë së dytë në zona tjera. Inspektimet rutinore apo pa paralajmërim janë bërë në grup inspektorësh në këtë rast përveç punëve në lëmin e ndërtimit janë kryer edhe punë në lëmi tjera duke u ndihmuar inspektorëve të lëmvë tjera. Për këtë periudhë raportuese janë rrënuar dy objekte ndihmëse në Komoran, ndërsa pas zhvillimit të procedurave, vullnetarisht janë larguar një autolarje në Poklek i Ri dhe tri kiosqe në Drenas. Gjatë kësaj periudhe është bërë kontroll e përgjithshme e të gjitha subjekteve dhe institucioneve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Kryesisht është bërë mbikëqyrja e zbatimit të vendimeve të Qeverisë, Vendimit të Kryetarit të Komunes, Ligjit për Tregti të Brendshme.

Spektori i Mjedisit

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Në sektorin e mjedisit gjatë kësaj periudhe, inspektori i mjedisit ka qenë i angazhuar rreth mirëmbajtjes së pastërtisë së qytetit, mbrojtja e ambientit nga ndotja, mbeturinat, zhurma, e me theks të veçantë inspektimi rreth ujërave të zeza sidomos në zonat rurale sipas kërkesave të qytetarëve.

Gjatë kësaj periudhe është bërë:

- Inspektimi i hedhjes së mbeturinave afër rrugëve, vendeve publike.
- Inspektimi i largimit të mbeturinave inerte në vendet ku ka pasur ndërtime.
- Inspektimet e operatorëve të cilët veprojnë në Komunën e Drenasit e që janë ndotës të ambientit.
- Inspektimet sipas kërkesave të qytetarëve rreth kanalizimeve, ujërave të zeza, plehrave, sidomos në zonat rurale.
- Gjithsejtë janë hartuar 281 procesverbale, janë shqyrtuar 66 kërkesa, janë dhënë 3 LMK (Leje mjedisore Komunale) si dhe janë shqiptuar 18 dënime mandatore.

Gjatë periudhës janar-qershor, në bashkëpunim me inspektorët e lëmive tjera është bërë kontroll e përgjithshme e të gjitha subjekteve dhe institucioneve për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Pasqyra e punës në shifra për periudhën Janar- Qershor 2020

Lëmia Inspektuese	Procesverbale Inspektime	Aktivendime	Gjoha mandatore	Fletëparaqitje	Kërkesa për	Pëlqime Sanitare	Nioftime	Rrenime+largime	Kërkesa	Kalkxime penale	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokalev	Konfiskim i targave dhe	Konfiskim i mallit
Sanitari	120	31	5	0	5	5	0	0	9	0	9	73	0	0
Treg	168	32	7	0	6	6	6	0	29	0	23	5	0	0
Komunikacion	61	2	1	0	0	0	0	0	3	0	3	0	28	0
Ndërtim	75	11	2	0	0	0	11	6	16	0	10	0	0	0
Mjedis	48	0	1	0	0	0	0	0	22	0	22	0	0	0
Totali	472	76	16	0	11	11	17	6	79	0	67	82	28	0

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

2.6. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa gjatë periudhës Janar- Qershor 2020, punët dhe detyrat e punës i ka kryer në bazë të planit -programit të punës, duke u bazuar në ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03/L-048, ligjin për financat e pushtetit lokal nr. 03/L-049, ligjin për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, rregulloret, udhëzimet e MF-it, vendimet e Kuvendit të Komunës, si dhe në bazë të detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me statutin e Komunës së Drenasit.

Drejtoria për Buxhet e Financa gjatë kësaj periudhe punën e ka orientuar në këto lëmi:

Raporti i punës dhe ai financiar për vitin 2020

Pasqyrat financiare për vitin 2020

Procesi Buxhetor strategjia fiskale 2021-2023, sipas kërkesave fillestare,

Aprovimi i shpenzimeve dhe certifikimi për buxhetin komunal sipas programeve dhe nën programeve (4,119),

Kryerja e pagesave lidhur me shpenzimet operative dhe ato kapitale dhe barazimi me SIMFK

Raportet e barazimit tre mujor me SIMFK,

Punët lidhur me arkën e parave të gatshme (arkëtimi dhe pagesat)

Regjistrimi i të gjitha të hyrave të arkëtuara në sistem nga burimet vetanake dhe barazimi i tyre ditor, javor, mujor dhe periodik me SIMFK

Përcjellja e të hyrave publike të akorduara nga B.K.K.

Përgatitja për transfer i parave të depozituara në llogarinë e Thesarit të MF-së,

Caktimi i tatimit dhe shpërndarja e faturave të tatimit në pronë 20,

Evidentimi i objekteve të reja si pasuri e paluajtshme dhe rimatja e atyre ekzistuese,

Përgatitja e analizave mujore lidhur me zhvillimin e buxhetit komunal,

Spektori i Buxhetit- për gjashtëmujorin e parë ka kryer këto pune dhe detyra pune: Zhvillimi i aktiviteteve për planifikimin e buxhetit 2021-2023, sipas kërkesave fillestare; Përgatitja e kornizën afatmesme Buxhetore 2021- 2022; Lëshimi i vërtetimeve për pasurinë e paluajtshme; Vërtetime tjera për qytetarë lidhur me rregullimin e dokumentacioneve; Kërkesa të regjistruara dhe koduara për shpenzime nga shfrytëzuesit e buxhetit; Lëshimi i faturave sipas kërkesave të palëve 12, 281; Ruajtja e data bazës për të dhënat e regjistruara; Objekte të reja të matura dhe rimatura; Fatura të shpërndara përmes postës 5,179; Numri i ankesave të pranuar pesë (5); Pranimi i kërkesave për regjistrimin e objekteve të reja 274.

Spektori i Thesarit — Në këtë sektor, punët dhe detyrat e punës për periudhën janar – qershor janë kryer si në vijim: Është bërë arkëtimi i parave të imta për shërbime ofiqarie, arkiv, gjeodezi, urbanizëm, pagesat e tatimit në pronë, pagesat për shpalljen e tenderëve. Përveç arkëtimit, është bërë depozitimi ditor i parave në llogarinë bankare të Komunës.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

- Regjistrimi i të hyrave vetanake të arkëtuara dhe regjistrimi në data bazë dhe në sistemin e free balancë.

- Transferi i të hyrave vetanake nga llogaria bankare e komunës në llogarinë thesarit pranë MF-s për çdo muaj.
- Hartimi i raporteve mujore për të hyrat vetanake për nevojat e ekzekutivit dhe MF-së.
- Zotimi i parave publike për qëllime të pagimit të shpenzimeve operative dhe kapitale sipas modulit të blerjes dhe aprovimit.
- Certifikimi UOP për të gjitha kategoritë - 1.349,
- Certifikimi i UOP për komunal - 512,
- Aprovimi i avanseve për para të imta - 68,
- Certifikimi i UOP për mallra dhe shërbime - 755,
- Certifikimi i UOP për Subvencione – 3,
- Certifikimi i UOP për Investime Kapitale - 11
- Dorëzimi i UOP në arkiv - 1349

Spektori i Financave ka kryer këto detyra pune: Përgatitja e pasqyrave financiare për vitin 2020; Certifikimi i dokumentacionit financiar për buxhetin komunal sipas programeve dhe nën programeve; Certifikimi i lëndëve për pagesë sipas modulit të aprovimit; Është mbajtur evidencë analitike për të gjitha lëndët e certifikuar sipas shpenzimeve - 1,349; Raporti i punës financiar për periudhën Janar-Mars 2020; Raporti i punës financiar për periudhën Janar-Qershor 2020; Plani i punës për vitin 2020.

Zyra e tatimit në pronë ka kryer këto detyra pune: Raste të reja 274; Verifikim tereni 550; Lëndë të miratuara intranet 4,612; Pagesa të pranuar në arkë 12,281 Modifikimi i të dhënave të pronës dhe tatimpaguesve 29; Regjistrim i tatimpaguesve 274 verifikime burimore 550; Certifikata të pagesës për TPr 5,179; Shpronësimet dhe ndërrimet e pronarëve 16; Referime kadastrale 30; Korrigjime dhe kalkulim manuale të pagesave 821; Riprogramim i marrëveshjeve 152; Kontrata shitblerjesh 44; Vendime nga bordi i ankesave 78; Certifikata të tatimpaguesve 5,179; Certifikata për jotatimpagues 267; Lidhja e marrëveshjeve për pagesë me këste 9; Regjistrimi i kontratave të shitblerjeve 18; Rikalkulimi i relacioneve të reja 30; Shqyrtimi i ankesave të tatimpaguesve 5; Shqyrtimi i kërkesave për korrigjim 11; Lëshuarja e faturave në mënyra manuale 3,000.

2.7. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, në bazë të infrastrukturës dhe strukturës organizative ofron shërbime shëndetësore në gjithë territorin e Komunës së Drenasit në bazë të konceptit të mjekësisë familjare. Këto shërbime shëndetësore janë gjithëpërfshirëse për të gjitha grup moshat. Kujdesi shëndetësor në bazë të rrethanave të kohës dhe përparimit të teknologjisë, ka një qasje të avancuar në aspektin e trajtimit dhe përkujdesjes shëndetësore, është një kohë e transformimit dhe një qasje gjithëpërfshirëse shëndetësore, mirëqenies sociale, ekonomike, epidemiologjike dhe rehabilituese.

Detyrat e përgjithshme Ligjore dhe statusore të QKMF-së

- Zbaton ligjin për shëndetësi me qëllim të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të qytetarëve.
- Zbaton politikat shëndetësore të hartuar nga DSHMS.
- Zbaton planin operativ të propozuar nga Kuvendi Komunal përmes DSHMS-së.
- Planifikimi i nevojave për resurse humane profesionale.
- Shfrytëzimi racional i buxhetit të aprovuar nga K. Komunal në bashkëpunim me DSHMS.
- Organizimin e punës në kujdesin parësor shëndetësor me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore profesionale dhe cilësore.
- Përmes protokolleve dhe udhërrëfyesve klinik përcjell trendin e trajtimit të sëmundjeve dhe Diagnostikimit.
- Zbaton udhëzimet administrative për kujdes parësor të hartuara nga Ministria e Shëndetësisë.
- Vlerëson nevojat lokale në bazë të të dhënave dhe parashtrohet DSHMS për hapat e veprimit.
- Raporton për situatën epidemiologjike DSHMS në mënyrë që të monitorohen situatat nga DSHMS.
- Bashkëpunimi me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare që kanë për qëllim përparimin e shëndetit.

Në kujdesin parësor shëndetësorë - KPSH-Bazohet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurt, të ndërtuara mbi parimet e konceptit të Mjekësisë Familjare, të drejtuara nga nevojat dhe kërkesat e individëve, familjeve bashkësisë, me synim të promovimit ruajtjes dhe përmirësimit të shëndetit për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

SHËRBIMET E INSTITUCIONEVE TË KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR

1. Shërbimet e promovimit shëndetësor, përfshirë informimin, komunikimin dhe edukimin
2. Shërbimet e imunizimit dhe vaksinimit dhe shërbimet tjera parandaluese
3. Shërbimet esenciale kurative dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike
4. Shërbime të kujdesit akut dhe urgjent
5. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për sëmundjet kronike
6. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijë, adoleshentë dhe të rinjtë
7. Shërbimet e planifikimit familjar
8. Shërbimet e kujdesit ante/peri dhe post natal

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

9. Shërbimet e shëndetit oral parandalues
10. Shërbimet e shëndetit mendor
11. Shërbimet e kujdesit shtëpiak përfshirë shërbimet e kujdesit neonatal dhe atij terminal palitativ
12. Shpërndarja e barërave nga lista esenciale.



ORGANIZIMI I KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR NË KOMUNËN E DRENASIT (zonimi)

1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF,

(Drenas)

5 Qendra të Mjekësisë Familjare – QMF


(Komoran, Gllanasellë, Arllat, Tërstenik dhe Baicë)

7 Ambulanca të Mjekësisë Familjare – AMF

(Nekoc, Sankoc, Gradicë, Dobroshec, Abri, Poklek, Terdec)

STRUKTURA E RE ORGANIZATIVE NË QENDRËN KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

QKMF – DRENAS



RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISIES LOKALE

Struktura e Trupave Profesionale të QKMF-së / Drenas 2019

Numri i përgjithshëm i stafit të certifikuar është 181 që është në funksion të organizimit, ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe stafi mbështetës jo shëndetësor administrativë dhe logjistik në bazë të nevojave dhe detyrave të punës. Në krahasim me vitet e kaluara numri i mjekëve në kujdesinë parësor është rritur në bazë të politikave shëndetësore të DSHMS-le për të plotësuar standardet 1 mjek në 2000 banorë, ku kjo politikë shëndetësore është në proces dhe planifikim nga DSHMS.

Burimet njerëzore në QKMF

STAFI I PËRGJITHSHËM I ANGAZHUAR NË SISTEMIN E KPSH-SË									
MP dhe Specialist a	Stomatolog ë	Farmacist	Infermier ë	Kudër i mesëm mjekësor	Administrat ë	Shoferë	Staf mbështetë s	CARITAS	
								Mjekë	Shoferë
37	3	1	75	27	8	5	15	4	2
171								6	
177									

Tabela 1.

Numri i përgjithshëm i resurseve humane angazhuar në KPSH

Sipas tabelës numri i mjekëve specialist dhe mjekë të përgjithshëm është 34, stomatolog 3, farmacist 1, infermier 77, kuadër i mesëm mjekësor 27 administratë 8, shofer 5, staf logjistik 15. Shërbime të blera nga Caritas – (mjekë 4 shofer 2) të cilët kryejnë shërbime të shëndetit palativ

STAFI MJEKËSOR I ANGAZHUAR NË SISTEMIN E KPSH SIPAS SPECIALIZIMIT										
	Mjekësi Familjare				Konsultativë					
	Stomatolog dhe Mr. Farmacisë 3+1	Nr. Spec. M.F.	Nr. Specializantëve MF	Nr. Mjekëve pa Specializim	Nr. Spec. tjerë sipas llojit të specializimit	Nr. Specializantë ve tjerë sipas llojit të specializimit	Nr. Total i Infermierëve në MF.	Nr. i Infermierëve të trajnuar në MF të Licencuar	Nr. i Infermierëve të trajnuar në MF të Pa Licencuar	Nr. Kuadrit të mesëm mjekësorë Rentgen, Laborant, Mami etj.
	Dr. Stomatolog dhe Mr. Farmacisë	Specialistë	Specializim	Dr. Pa Specializim	Specialistë tjerë	Specializantë tjerë	Infermier	Infermier të trajnuar	Infermier të trajnuar pa Licencë	Laborant, Mami, Tekn. Rentgen
M	1	2	2	7	5	-	7	7	-	6
F	3	8	3	5	3	1	69	69	-	22

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Gj	4	10	5	12	8	1	75	-	27
	4	27			9		75		27
	40						102		
142									

Tabela 2. Numri i stafit mjekësor i angazhuar në sistemin e KPSH(2019)

Sipas tabelës numri i resurseve humane profesionale shëndetësore është 142. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare së bashku me njësitë e saja përmbushë pothuajse 80% të shërbimeve shëndetësore të qasshme dhe cilësore për komunitetin. Rrjeti shëndetësor është i dizajnuar dhe i zbatueshëm në bazë të nevojave të komunitetit, ku distanca e secilës njësi është më e shkurtër se 10 km e që arritshmëria duke ju falënderuar infrastrukturës rrugore që ka komuna e Drenasit është për një kohë më të shkurtër se 7 minuta në dhënien e vizitës dhe tretmanit shëndetësor.

Reforma institucionale dhe përmirësimi i praktikës menaxhuese në sistemin shëndetësorë / prioritetet e përcaktuara rezultojnë pozitivisht në këto elemente:


- 1.. Zhvillimi i konceptit të qasjes në mjekësinë familjare;
2. Ulja e nivelit të vdekshmërisë dhe sëmundjeve të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare;
3. Ulja e nivelit të vdekshmërisë dhe sëmundjes maternale (para, gjatë dhe pas lindjes);
4. Ulja e nivelit të incidencës dhe ndikimit të sëmundjeve ngjitëse duke përfshirë TBC dhe HIV/AIDS;
5. Ulja e nivelit të pirjes së duhanit;
6. Stabilizimi i incidenteve me ndikim në sëmundjet mentale;
7. Zvogëlimi i incidenteve me ndikim në sëmundjet kardiovaskulare;
8. Përmirësimi i gjendjes me barëra esenciale;
9. Përmirësimi i menaxhimit të financave dhe prokurimit në sektorin e shëndetësisë;
10. Përforcimi i kornizës ligjore dhe rregullative.

Vizitat dhe shërbimet mjekësore në QKMF dhe njësitë organizative - Ne bazë të të dhënave statistikore dhe vëllimit të punës në periudhën Janar – Qershor janë evidentuar 14580 vizita mjekësore; 13828-shërbime mjekësore e që në total vizita dhe shërbime – 28408. Këto të dhëna na tregojnë për një qasje e kënaqshme për kërkuesit e shërbimeve shëndetësore dhe një parametër i rëndësishëm ku mbi 80% e popullatës së Drenasit si qasje të parë kanë zgjedhur Kujdesin parësor shëndetësor për tretman mjekësor. Krahasuar me vitin paraprak numri i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore është më i ulët. Arsyeja qëndron se për shkak të pandemisë COVID-19 dhe masave të marra nga MSH për ofrimin e shërbimeve jo esenciale. Me shpalljen e gjendjes për gatishmëri të lartë nga Qeveria RK, ne me rekomandim të IKPSH qasja në shërbime shëndetësore gjatë kësaj periudhe është organizuar në bazë të rekomandimeve të IKSH dhe Shtabit Operativ të Komunitetit të Drenasit në mbikëqyrje të DSHMS. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore 24 orë në QKMF Drenas dhe QMF Komoran në kohë pandemie ka ndikuar në qasje të lehtë për kërkuesit e shërbimeve shëndetësore, por mbetet një sfidë

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE


si do të vepohet më tutje duke marr parasysh se kjo gjendje pandemie është ne rritje te rasteve dhe infektim të personelit shëndetësor që paraqet një ngarkesë për stafin ekzistues. Në diagram janë pasqyruar vizitat dhe shërbimet në të gjithë sektorët dhe njësitë e QKMF. Në bazë të diagramit vërehet se frekuentimi i pacientëve është i shprehur në sektorin e mjekësisë familjare dhe urgjencës. Diagrami i sektorit diagnostik Laboratorit janë të pasqyruara aktivitetet e shërbimeve shëndetësore dhe jo frekuentimi i pacientëve.

Vizitat dhe shërbimet QKMF- Drenas



Diagrami 1


Diagrami 2. Në QMF Komoran numri i vizitave mjekësore në MF janë 23348 shërbime mjekësore 36041; Shërbimi i kujdestarisë janë kryer vizita 8533, shërbime 6884 që janë të pasqyruara në diagram shërbimi i laboratorit janë të shprehura aktivitetet.



Diagrami 2

Diagrami 3. Këtu është paraqitur numri i vizitave dhe shërbimeve në sektorët e QMF-ve, AMF-ve dhe sektorin e urgjencës, ku në shikim të parë vërehet se frekuentimi i pacientëve është i koncentruar në QMF Drenas, QMF Komoran dhe Shërbimin e urgjencës përkundër pranisë së shërbimeve shëndetësore në qendrat tjera dhe qasjes më të lehtë për shërbime e që në këto qendra ku frekuentimi është më i shprehur koha e pritjes është më e gjatë dhe pakënaqësia e pacientëve më e shprehur, prandaj kemi një shfrytëzim jo racional të resurseve profesionale shëndetësore.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE



Diagrami 3

Diagrami 4. Në këtë diagram është pasqyruar morbiditeti (sëmundshmëria) në bazë të diagnozave të nxjerra nga SISH të raportuara nga shërbimet përkatëse. Problemet më të shpeshta në bazë të diagnozave janë ato të sëmundjeve të sistemit respirator (frymëmarrjes), e që të shprehura në përqindje nga numri i përgjithshëm i diagnozave radhitë:

1. Patologjitë e sistemit respirator	23.73%
2. Sëmundjet e sistemit digjestiv	8.5%
3. Sëmundjet e sistemit osteomuskular	10,0 %
4. Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	7.8%
5. Sëmundjet e sistemit urogenital	5.7%
6. Sëmundjet e sistemit të gjëndrave me tajim të brendshëm (diabeti)	4.7%

Në bazë të raporteve të diagnozave sëmundjet e sistemit respirator kanë një përqindje më të lartë që përfshin moshat mesatare dhe të shtyra si shkaktar përhapja e pandemisë COVID19 që këto gjendje shëndetësore janë shprehur dhe rastet të diagnostifikuara dhe të dyshuara për COVID 19 me etiologji virale.

Sëmundjet e sistemit kardiovaskular që është i shprehur 7.8% paraqet një problem shëndetësor në rritje për arsye të mungesës së aktiviteteve, stresit, trendit të jetesës dhe ushqimit kalorik. Sëmundjet e sistemit osteomuskular janë të shprehura me 10.0% e që përfshinë moshat mesatare të popullatës me një dekurs kronik si pasojë e trendit të jetës.

Kujdesi ndaj të moshuarve dhe paliativ - Kujdesi ndaj të moshuarve dhe paliativ ka qenë një sfidë e do të jetë edhe vitin e ardhshëm për arsye të mungesës së qendrave rehabilituese për këto kategori, faktikisht është barrë e kujdesit parësor shëndetësor dhe që ka një kosto të lartë buxhetore dhe një përkushtim kohor të gjatë. Mungesa e programeve dhe plotësimi i kriterëve 1 mjekë familjarë në 2000 banorë, ka përcjell vështirësitë përkundër blerjeve të shërbimeve shëndetësore nga Caritasi.

Numri i vizitave shtëpiake është 895.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Numri i vizitave dhe shërbimeve shtëpiake është 1134.

Shërbimi i urgjencës

Numri i vizitave dhe shërbimeve në këtë sektor janë të paraqitura në grafikonet e më sipërme. Efikasiteti i këtij shërbimi është i rritur në veprimet e rasteve emergjente në dhënien e ndihmës në vendin e ngjarjes dhe rastet emergjente janë transportuar konform standardeve në SHKSUK në QE .Transportimi i këtyre rasteve është bërë me urdhëresë të mjekut në njësinë e urgjencës ose të mjekut familjar në raste kur është paraparë nga mjeku se një shërbim i tillë është i domosdoshëm për pacientin. Në krahasim me vitin e kaluar shërbimi i urgjencës ka rritur efikasitetin, ku rastet janë transportuar konform standardeve në kohë dhe në bazë të protokolleve të shërbimit emergjent.

Në vitin 2019 janë transportuar 1206 raste.

Në vitin 2020 janë transportuar 1416 raste .

Numri i rasteve të paraqitura me Cov-19

Në Komunën tonë persona në vetë izolim kemi pasur nga data 27.02.2020. Gjatë kësaj periudhe kohore ne kemi angazhuar ekupe në teren për vet izolim të personave që kanë hyrë në pikat kufitare, po ashtu kemi mbajtur edhe aeroportin e Prishtinës varësisht sipas ardhjeve dhe orareve që i kemi pasur në si qendër. Nga data 28.02.2020 kemi mbajtur kujdestari 12 or në Aeroportin e Prishtinës, varësisht nga orari që na është caktuar. Rasti i parë me COVID -19 në Komunën e Drenasit ka dalë me 18.04.2020. Deri me 30.06.2020 kemi pasur 20 raste COVID-19 Pozitiv.

Diagrami 4. Vizitat nga programi; Vizitat në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët deri në 3 vjeç.

Për shkak të Pandemisë COVID19 ky program një kohë është ndërprerë dhe ka pasur ngecje në realizimin e kënaqshëm të këtyre vizitave, por gjatë kësaj kohe janë dhënë këshilla përmes telefonit nga stafi shëndetësor. Numri i vizitave në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët deri në 3 vjet për vitin 2020.

	Numri	Komente
Numri i vizitave shtëpiake për fëmijë	43	
Numri i vizitave shtëpiake për shtatzëna	42	
Nr. total i vizitave shtëpiake të kryera (gjatë një muaji)	85	
Nr. i fëmijëve vajza të cilat kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0- 3 vjet (Janë vizituar për herë të parë)	14	
Nr. i fëmijëve djem të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0- 3 vjet (Janë vizituar për herë të parë)	17	
Nr. Total i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0- 3 vjet (Janë vizituar për herë të parë)	31	
Nr. i shtatzënave që kanë pranuar 1 vizitë gjatë shtatzënisë (Janë vizituar për herë të parë)	21	

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes	7	
Numri i familjeve Romë, Ashkali dhe Egjiptian që kanë pranuar të paktën një vizitë shtëpiake		
Numri i fëmijëve të referuar tek specialistet mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare		
Numri i infermiereve që janë duke i zbatuar vizitat në shtëpi	1	

Numri i përgjithshëm i vizitave për këtë program është 260. Asistimi i ekipeve mjekësore në ndeshjet futbolistike në bazë të marrëveshje me DSHMS dhe Klubeve futbolistike në vitin 2020.

Njësia e Shëndetit Publik – Vaksinimi - Njësia e shëndetit publik - vaksinimi në bazë të të dhënave statistikore dhe periudhës 6 vjeçare ka vështirësuar gjatë kësaj periudhe kohore për shkak të pandemisë COVID-19.

Dhënia e vaksinave (gjithsej dozat e aplikuara) == 2491

Anketa epidemiološke 3

Paraqitja e epidemive ----- 1

Heqja e rrigrave = 124.

Njësia e SISH-it

Kjo njësi gjatë vitit ka bërë përpjekje maksimale në aplikimin e Ueb aplikacionit përkundër vështirësive gjatë punës mungesa e rrjetit në të gjitha njësitë, rënia e shpeshtë e rrjetit, ndryshimet në harmonizimin e Ueb aplikacionit megjithatë vizita e delegacioneve nga MSH si dhe shtrirja e rrjeti edhe ne OMF e tjera.

Departamenti i Maternitetit;

Numri i lindjeve ----- 20

Netët e qëndrimit për foshnje ----- 46

Netët e qëndrimit për gra shtatzëna----- 49

Vizita gjinekologjike ----- 99

CTG ----- 112

Barnatorja Qendrore

Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor është bërë nga MSH dhe të hyrat vetanake nga buxheti DSHMS. Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësorë nga MSH nuk ka qenë i mjaftueshëm në bazë të kërkesave për shërbime bazike shëndetësore dhe nevojave të pacientëve prandaj shumicën e barnave pacientët i kanë blerë. Arsyeja ka qenë buxheti jo i mjaftueshëm në bazë të kërkesave dhe nevojave. Duke pasur parasysh këtë gjendje me qëllim të tretmanit terapeutik emergjent, DSHMS nga të hyrat vetanake, ka

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

plotësuar një pjesë me barna dhe material shpenzues mjekësor. Ne vazhdim raportin 6-mujor të hyrjeve për barna dhe material shpenzues mjekësor nga LEB/MSH dhe nga hyrjet vetanake, gjithashtu edhe donacionet për material mbrojtës për stafin shëndetësor, Anti COVID-19 të pranuar nga MSH dhe disa donatore të tjerë.

Te pranuar nga donacionet	sasia totale mars-korrik
Maska kirurgjike dyshtresore	3880
Maska respirator FFP2	3050
Maska KN95	2500
Veshje mbrojtëse	2030
Doreza josterile	22700
Dezinfektues	272
Alkool 70% a 1L	208
Termometer IR	5
Mburoje për fytyrë	550
syze mbrojtëse	368
Doreza sterile	13600
Dezinfektues për mjete	1
Set steril (kombilizon)	10
Kemisha për pacienta	10
Përparëse për një përdorim	1028
Kalaja për këmbë	100
Shtroja për krevat	580
Qante për transp.mostrave	5

Te pranuar nga LEB/MSH	gjithsej
janar	11890
shkurt	10344.53
mars	11669.41
prill	10698.51
maj	10276.7
qershor	10957.1
	€65,836.25

insulina	
janar	6124.8
shkurt	6783.2
mars	6874.2
prill	6497.7
maj	6961.7
qershor	6961.7
	€40,203.30

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISËS LOKALE

Çarçaf për krevat 60x60	290
-------------------------	-----

Te pranuar nga hyrjet vetanake	
Sinorg 20.02.2020	4241
Sinorg 15.07.2020	1770
gjithsej	€6,011

Raporti financiar i nxjerrë nga sistemi FREEBALANCE

Viti Fiskal 2020								
Përshkrimi	Shuma e Alokuar	Aktuali	Obligimet	Fondet jo e obliguar		Zotimet	FreeBalance	
				Shuma	???		Shuma	???
OBJ / UNIT / SPROG / MOBJ	A	B	C	D=A-(B+C)	D/A	E	F=D-E	F/A
10 BUXHETI	1,370,437.96	941,412.22	5,056.61	423,969.13	30.94	3,294.45	420,674.68	30.70
611 GLLOGOC	1,370,437.96	941,412.22	5,056.61	423,969.13	30.94	3,294.45	420,674.68	30.70
73100 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - GLLOGOC	1,370,437.96	941,412.22	5,056.61	423,969.13	30.94	3,294.45	420,674.68	30.70
111 PAGA DHE SHITESA	814,858.12	814,858.12	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
130 MALLRA DHE SHËRBIME	235,019.84	105,018.12	3,662.53	126,339.19	53.76	3,294.45	123,044.74	52.36
132 SHPENZIME KOMUNALE	33,966.00	21,535.98	1,394.08	11,035.94	32.49	0.00	11,035.94	32.49

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

300 PASURITË JOFINANCIARE	286,594.00	0.00	0.00	286,594.00	100.00	0.00	286,594.00	100.00
21 TE HYRAT VETANAKE	12,583.50	0.00	0.00	12,583.50	100.00	0.00	12,583.50	31.33
611 GLLOGOC	12,583.50	0.00	0.00	12,583.50	100.00	0.00	12,583.50	100.00
73100 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - GLLOGOC	12,583.50	0.00	0.00	12,583.50	100.00	0.00	12,583.50	100.00
111 PAGA DHE SHITESA	12,583.50	0.00	0.00	12,583.50	100.00	0.00	12,583.50	100.00
22 TË HYRAT VETANAKE - 2018	40,630.75	8,643.28	0.00	31,987.47	78.73	0.00	31,987.47	32.68
611 GLLOGOC	40,630.75	8,643.28	0.00	31,987.47	78.73	0.00	31,987.47	78.73
73100 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - GLLOGOC	40,630.75	8,643.28	0.00	31,987.47	78.73	0.00	31,987.47	78.73
111 PAGA DHE SHITESA	26,737.30	0.00	0.00	26,737.30	100.00	0.00	26,737.30	100.00
130 MALLRA DHE SHËRBIME	5,250.17	0.00	0.00	5,250.17	100.00	0.00	5,250.17	100.00
300 PASURITË JOFINANCIARE	8,643.28	8,643.28	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Totali I Përgjithshme	1,423,652.21	950,055.50	5,056.61	468,540.10	32.91	3,294.45	465,245.65	32.68

Raporti Statistikor 6 mujor periudha kohore janar - qershor 2020 i Shërbimeve Sociale.

Raport statistikor për periudhën Janar-Qershor-2020 i Skemës së Asistencës Sociale ne QPS-Drenas

Muaji	Nr. i familjeve
Janar	1120
Shkurt	1101
Mars	1071
Prill	1125

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Kategoria		Te bartura nga viti 2019	Lëvizja e lendeve (periudha 6 mujore 2020)		Lendet që barten për periudhën tjetër-2020
			Të reja	Të mbyllura	
1.	1. a -Fëmijët e braktisur	13	1	1	13
	b- Fëmijët jetim (pa dy prindër)	6	-	1	5
	c- Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrave prindërore	11	-	1	10
	d- Fëmijë të strehuar në familje strehuese, apo SOS-fshati	1	-	1	1
2	Familje Strehuese	1	1	-	1
3	Kërkesa për adoptim vendor	-	2	-	2
4	Kërkesa për adoptim ndërkombëtar	-	-	-	-
5	Fëmijë të keqtrajtuar	7	5	2	10
6	Fëmijët me sjellje asociale	7	4	1	10
7	Te miturit ne konflikt me ligjin	9	4	1	12
8	Viktimat e dhunës familjare	20	17	4	33
9	Viktimat e trafikimit	2	1	-	2
10	Viktimat e krimeve seksuale	4	-	-	4
11	Martesa e të miturve	-	1	-	1
12	Pune të renda(rrezikshme) të fëmijëve		-	-	-
13	Kërkues të këshillimit martesor	21	12	3	30
14	Te moshuarit	8	2	-	10
15	Kl. Tjerë:		2		17
	a- Nenat vetushqyese				
	b- Persona me aftësi të kufizuar	13	13	-	26
	c- Pers. me aftësi të kufizuara me pagese	70	13	1	82
	4. d-Dok. Administrative	-	-	-	-
	e-Arsye tjera	3	7	-	10
	Gjithsej:		82	16	279

2.8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Zyrtarët nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, detyrat e punës i kanë kryer duke u bazuar në planprogramin e punës, duke u mbështetur në ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të detyrave e obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Gllgocit.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Në bazë të detyrave që janë realizuar gjatë pjesës së parë të vitit 2020, zyrtarët përgjegjës kanë përgatitur këtë raport të punës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020:

Në sektorin e planifikimit jemi angazhuar si drejtori në përmirësimin e procedurave për aplikimin e lejeve, kërkesave të qytetarëve, investitorëve dhe përkrahjen e iniciativave për të pasur një planifikim urban të qëndrueshëm të qytetit. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban janë trajtuar brenda afatit ligjor kërkesat dhe janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe leje të ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, duke filluar nga Planin Zhvillimor Komunal dhe Urban si dhe Planet Rregulluese Urbane.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2020, kemi miratuar Planin Zhvillimor Komunal (PZHK) të Gllogocit 2020-2028, i cili është dokument i planifikimit hapësinor që paraqet një bazë të mirë për zhvillimin komunal. Planin Zhvillimor Komunal është një pasqyrë e zhvillimit të Komunës së Drenasit dhe është një plan strategjik multi-sektorial i cili përcakton periudhën afatgjatë (8 vite) të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Deri në miratimin e këtij dokumenti, janë ndjekur të gjitha fazat e diskutimeve me qytetarë e grupe të interesit, për të qenë sa më transparent. Fazat që ka kaluar procesi i PZHK-së janë, profili, vlerësimi i gjendjes ekzistuese, koncepti i zhvillimit hapësinor dhe prioritetet strategjike me planin e veprimit. Të gjitha këto faza janë përcjellë me pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe akterëve tjerë relevant.

Në bashkëpunim me GIZ-in gjerman kemi filluar me procedurat për Hartimin Hartës Zonale të Komunës (HZK), si dhe kemi krijuar bazën e të dhënave hapësinore të Komunës sonë, deri më tani kemi draftin e parë të Hartës Zonale të Komunës, dhe është filluar me Hartimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për HZK-në, e cila aktualisht është në Konsultim publik në afat prej 30 ditësh, Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Harten Zonale Komunale të Gllogocit, në mënyrë që qytetarët me pjesëmarrjen e tyre të ndihmojnë në përfundimin e procedurave për aprovimin e Raportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale Komunale.

Në gjashtë mujorin e parë të këtij viti është shënuar Dita Ndërkombëtare e Mjedisit me 5 qershor 2020, e cila ka për qëllim rritjen e vetëdijes për çështjen e mjedisit dhe mbrojtjen e mjedisit në nivel lokal dhe global. Dita Ndërkombëtare e Mjedisit u shënuar me aktivitete në mbjelljen e drunjve dekorativë në shkollat fillore të qytetit të Drenasit dhe me aktivitete tjera pastrimi, është publikuar dhe lidhur kontrata për tri vite për projektin "Tabelat për emërtimin e rrugëve dhe vendbanimeve të Drenasit dhe numra të hyrjeve (objekteve)", të cilat gjatë gjashtë mujorit të dytë do të vendosen në terren dhe do të vazhdojë implementimi i këtij projekti sipas kontratës kornizë 2020-2022.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, është filluar me procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, në të cilën është formuar grupi punues për legalizimin e ndërtimeve pa leje në përbërje prej 12 anëtarëve, në të cilën detyrë e anëtarëve të këtij grupi punues është që të shqyrtoj të gjitha kërkesat- lëndët e pranuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit për legalizim të ndërtimeve pa leje të ndërtuara para datës 05.09.2018, në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe akteve të tjera nënligjore.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Deri me tani sipas evidencës, dhe shqyrtimeve të lëndëve nga grupi punues për legalizimin e ndërtimeve pa leje, janë aprovuar 10, dhe janë marr Vendime për Dhënie të Certifikatës së Legalizimit, 8 Vendime për përfshirje në listë të pritjes, 23 lëndë janë dërguar Informim aplikuesve për plotësim dhe korrigjim të dokumentacionit, 12 lëndë janë në proces të shqyrtimit, gjithsej janë 53 lëndë të cilët u janë nënshtruar procesit të legalizimit të ndërtimit pa leje.

Lista e punëve të realizuara gjatë gjashtë muhorit të parë të vitit 2020;

- Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal të Gillogocit 2020-2028.
- Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Gillogocit, 2020-2028.
- Inicimi dhe Miratimi i Vendimit për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (FORSYTHIA EUROPEA) në zonën e Goleshit- Fshatin Sankoc në kategorinë- monument i natyrës.
- Shqyrtimi i kërkesave dhe lëshimi i kushteve, lejeve të ndërtimit në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të ndërtimeve.
- Emërtimi i rrugëve dhe numrave në hyrje të objekteve.
- Shqyrtimi i kërkesave dhe vendimmarrja për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit 5 qershor 2020, në përkrahjen e iniciativave në ruajtjen e mjedisit.
- Gjellbërimi i hapësirave publike.
- Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Gillogocit 2020-2028.

2.9. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi është përgjegjëse për:

- a. zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale, rrjetin referues homogjene, sigurimin e hartave Orto-Foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informative për tokën dhe pronën,
- b. sigurimin e zotërimit të tokës, reduktimin e kontesteve për tokën,
- c. përmirësimin e transferimit të tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në taksimin e tokave,
- d. planifikimin e rrjetit me pika të reja kontrolluese dhe themelimin e pikave të reja kontrolluese,
- e. digjitalizimin e pikave poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale),

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISËS LOKALE

- f. azhurnimin e pjesës grafike në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe transformimin me parametrat e dhëna për transformim,
- g. shërbimin e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,
- h. ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastin e shpronësimit, dhe zhvillimin e procedurave.
- i. inspektimin e sipërfaqes së ndërtesave dhe përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,
- j. regjistrimin e pronës së paluajtshme dhe regjistrimin e tokës komunale,
- k. zhvillimin e procedurës së regjistrimit, sipas detyrës zyrtare dhe kërkesave të palëve,
- l. korrigjimin e regjistrit (RDPP) sipas procedurave dhe zbatimi i të gjitha dispozitat pozitive në fuqi,
- m. azhurnimin e pronës, në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor, azhurnimin e regjistrit të ndërrimeve të mjeteve nga terreni,
- n. kryerjen e procedurave rreth transaksioneve të pronës publike dhe kryerjen e procedurave të blerjes dhe shitjes së pronës për komunën,
- o. shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për rikthimin e tokës pronarëve të mëparshëm,
- p. mbrojtjen e pronës komunale – publike dhe kryen procedurat lidhur me këtë çështje,
- q. vërtetimin dhe zbatimin e shitblerjes së pasurisë së patundshme,
- r. regjistrimin e ndërtesave kolektive dhe organizon mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta të tyre,
- s. udhëheqjen me kadastrën etazh të banesave, ndërtesave, si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të ndërtuara banesat,
- t. regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave,
- u. aktvendimet mbi regjistrimin e servituteve, qira mbajtjeve dhe barrave të ndryshme,
- v. lëshimin e certifikatave personave që nuk kanë patundshmëri,
- ë. mirëmbajtjen, korrigjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve, fshatrave, shesheve, rrugëve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave,
- x. nxjerrjen e aktvendimeve për miratim ose refuzim të kërkesave,
- y. nxjerrjen e konkluzioneve për plotësimin e kërkesave të pakompletuara,
- z. përgatitjen e projekt programit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin e punës,
- aa. Kryerjen e punëve të tjera në pajtim me dispozitat ligjore (shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe të institucioneve tjera),
- bb. mbajtjen e shënimeve për tërë tokën dhe objektet, të cilat i posedon apo i shfrytëzon Komuna,
- cc. zhvillimin e procedurës së eksproprijimit, shpronësimit dhe deeksproprijimit të tokës në pronësi të Komunës,
- dd. trajtimin dhe zhvillimin e procedurës administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës.

Spektori i Gjeodezisë brenda kompetencës lëndore, kryen punët si në vijim:

- Shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit dhe kulturave të tokës,
- Ndarjen e parcelave,
- Bashkimin e parcelave sipas kërkesës së palëve,

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISIES LOKALE

Përpunimi i skicave të ndarjeve për ndërtesa dhe banesa,
-Rilevimi i sipërfaqes së ndërtesave,
-Përsëritja e kufijve të parcelës,
-Shënimi i kufijve në rastin e eksproprijimit,
-Identifikimi i ngastrave dhe objekteve kadastrale,
-Nxjerr Aktvendime dhe Konkluzione lidhur me kërkesat e palëve,
-Punët tjera gjeodezike.

Me kërkesë të Drejtorisë për Infrastrukturë Lokale është bërë identifikimi i mbi 50 parcelave në më shumë se 10 zona kadastrale, sipas planit zhvillimor të kompanisë KEDS, për modernizimin e rrjetit të shpërndarjes së rrymës elektrike në Komunën e Drenasit. Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike janë incizuar të gjitha rrugët e qendrës së Drenasit dhe Komoranit, të cilat matje janë përpunuar dhe janë dorëzuar në DWG.

Është përgatitur elaborati i shpronësimit për rrugën tranzitore Feronikel-Kroni i Mbretit. Po ashtu, është përgatitur edhe elaborati i shpronësimit për parcelat kadastrale në Krajkovë, në të cilat ndodhet burimi i ujit të pijes, rezervuari dhe objekti. DGJKP ka bërë kërkesë për bashkimin parcelave (6), koordinatat e parcelave (30), për ndarjen e parcelave (25), dhe për regjistrimin e ndërtesave apo njësisve të ndërtesave (4) dhe kopje plani gjithsejtë (243). Lëndët për korrigjimin e kufijve të parcelave janë 19, ndërsa, lëndët të cilat janë azhuruar nga vitet e kaluara në KADMAP janë 25. Gjatë realizimit të këtyre kërkesave, janë arritur të hyrat në shumë prej 1,987.00€, si dhe 4,089.00€ për kopje të planit dhe fleta poseduese. Gjithsej të hyra nga shërbimet gjeodezike dhe kopje të planit janë 6,076,00 €.

Sektori i Gjeodezisë është i ndërlidhur ngushtë me sektorin e kadastrit dhe është e pamundur të funksionoj njëra pa tjetrën, të gjitha lëndët që fillojnë nga sektori i gjeodezisë dhe pas shqyrtimit dhe përpunimit të këtyre lëndëve aprovohen nga ky sektor dhe pastaj nga pala parashtrohet kërkesa në sektorin e kadastrit për t'i regjistruar në SIKTK-T. Sektori i Gjeodezisë bashkëpunon me sektorin e pronës si në raste për definimin e pronave komunale, për përcaktimin e kufijve të parcelave, konstatime të ndryshme që janë të uzurpuara pronat dhe marrim pjesë gjatë lirimit të pronave komunale për t'i caktuar kufijtë e parcelave.

Sektori i Gjeodezisë gjatë këtij viti ka filluar për të azhuruar në plane kadastrale autostraden 'Ibrahim Rugova' N9, nga Korroticë e Epërme – Gjergjicë, që ka qenë në interes shumë të madh për komunën tonë. Kjo rrugë ka qenë e shpronësuar gjatë viteve 2009/12 dhe nuk është azhuruar deri në këtë vit. Gjatë muajit qershor janë bërë matje në 'Lagjen e Re' në Komoran, me qëllim që të bëhet azhurimi i parcelave kadastrale, të cilat parcela janë prona komunale, por janë dhënë në shfrytëzim të përhershëm, sepse këto parcela nuk janë të azhuruara në sistem.

Përveç punëve që kemi në sektorin e gjeodezisë, gjatë këtij viti, kemi qenë të angazhuar edhe me komisione të ndryshme si: Komisioni për verifikimin e gjendjes së të gjitha pronave të paluajtshme komunale të dhëna në shfrytëzim, komisioni për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, komisioni për plan zhvillimor komunal, komisioni për shqyrtimin e kontratave të objekteve lokale-

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

banesore që janë prona komunale, komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore.

Detyrat e Sektorit të Kadastrit

Dhënia e certifikatave të pronës së paluajtshme.....	686
Dhënia e certifikatave që nuk posedojnë prone	785
Regjistrimi i shitblerjes së pronës së paluajtshme.....	23
Regjistrimi i ndarjeve të parcelave	20
Regjistrimi i bashkimit të parcelave.....	16
Regjistrimi i hipotekës.....	26
Fshirje të hipotekës.....	15
Regjistrim i kërkesave për ndarje.....	2
Regjistrimi për bartje të pronësisë- dhurimet.....	38
Regjistrimi për bartje të pronësisë- trashëgimi.....	30
Ekstrakt të pronave që janë në komosacion.....	112
Fletëpagesa për shërbime kadastrale	24
Regjistrimi i qiramarrjes/nënqiramarrjes.....	4
Modifikime të të dhënave të personit pa njësi kadastrale.....	31
Regjistrimi i ndërtesës ose pjesëve të ndërtesës	11
Regjistrimi i servitutit.....	1
Regjistrimi i këmbimeve.....	7
Modifikimi i ngastrave.....	496

Nga të gjitha këto punë të realizuara, përkatësisht regjistrimi i pronave, Sektori i Kadastrit ka arritur të hyra 6, 160,00 €.

Detyrat e Sektorit të Pronës

-Zhvillon procedurat e shpronësimit të tokave në pronësi private për interesat e përgjithshme shoqërore,

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

-Zhvillon procedurat e deeksproprijimit, gjegjësisht nulimit të aktvendimeve të plotfuqishme rreth shpronësimit në rastet kur plotësohen kushtet ligjore,

-Kujdeset për mbrojtjen e të dhënave pronësore, ku bartës i së drejtës së shfrytëzimit është Kuvendi Komunal,

-Udhëheq procedurën administrative lidhur me uzurpimet arbitrare,

-Mbanë evidencë për lëndët e uzurpimeve,

-Kujdeset për procedurat në përputhshmëri me ligjet në fuqi,

-Kryen procedurat e eksproprijimit,

-Nxjerr aktvendime, konkluzione lidhur me kërkesat e parashtruara, etj.

Në periudhën raportuese janë kryer 38 kërkesa – lëndë nga administratorët e fshatrave apo nga Drejtoritë e Komunës së Drenasit. Është bërë klasifikimi dhe vendosja e të gjitha dokumenteve që i posedon sektori i pronës në foldera, duke i klasifikuar sipas vitit dhe përmbajtjes. Po ashtu, është krijuar edhe arkiva elektronike e të gjitha dosjeve të zyrës së sektorit të Pronës.

Janë kryer 3 propozim vendime, të cilat janë miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit dhe janë dërguar për procedura të mëtejme në Qeveri. Po ashtu, ka përfunduar procedura administrative edhe për pronën në Krajkovë, ku ndodhet burimi i ujit të pijes. Për 17 raste është bërë incizimi në terren dhe është zhvilluar procedura administrative rreth uzurpimit të pronës komunale, ku edhe janë lëshuar 17 aktvendime për uzurpatorët në Zonën Kadastrale në Polluzhë. Gjithashtu janë liruar disa rrugë nga uzurpimet, në zona të ndryshme kadastrale të Komunës së Drenasit.

Të hyrat vetanake sipas programeve dhe fushave kryesore të të hyrave të planifikuara për vitin 2020, të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë.

Tax regj.prone			562.00	2,089.00	1,508.00	140.00	825.00	1,036.00	6,160.00
Tax fl.pos.kop.pl.			926.00	997.00	630.00	32.00	423.00	1,081.00	4,089.00
Matje gjeodezike			742.00	332.00	43.00		231.00	639.00	1,987.00
Shitja e pronës-autos.									-
			2,230.00	3,418.00	2,181.00	172.00	1,479.00	2,756.00	12,236.00

Raporti i lëndëve sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

02/01/2020 - 30/06/2020, Drejtorja: DGJPK

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Shkurtesa	Pershkrimi	Pranuar	Ne Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshte	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Perfunduar	Totali
DGJPK	Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër	4	3	1,914	5	0	12	0	30	0	1,968
		4	3	1,914	5	0	12	0	30	0	1,968

2.10. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË

	Arritjet/progresi/përformanca kyçe gjatë vitit 2020
Aktivitetet kryesore Janar-Qershor 2020	Në pajtim me nenin 17 pika f e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 82 të Statutit të Komunës së Drenasit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, gjatë vitit 2020 është angazhuar që të realizojë punët dhe detyrat që kanë qenë të parapara me plan programin e punës.
Aktivitetet për Ditën Ndërkombëtare të Tokës dhe Mjedisit	DSHPE me dt. 22/04/2020 shënoi 22 Prillin - Ditën Ndërkombëtare të Tokës dhe më datën 05/06/2020 Ditën Botërore të Mjedisit. Në këto dy ditë mjedisore janë realizuar aktivitete të rëndësishme si: - Pastrimi i hapësirave publike në Qendër të qytetit; - Mbjellja e luleve; - Mbjellja e drunjve në Shkollat Fillore të Mesme të Ulët "Rasim Kiçina", "Halil Bajraktari", "Arif Shala". - Largimi i mbeturinave në brezin rrugorë të rrugës "Ajet Rrukiqi"; - Largimi i deponive ilegale;
Aktivitetet në fushën e menaxhimit të mbeturinave	Për të arritur objektivat Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, përkatësisht aktivitetet që janë të parapara në këtë plan janë realizuar këto aktivitete: 1. Përmes bashkëfinancimit nga komuna e Drenasit dhe mbështetur nga bashkëpunimi Gjerman për zhvillim - GIZ, komuna e Drenasit ka përfituar projektin "Kompostimi Shtëpiak" në vlerë prej 326 shportave (komposterëve) për ndarjen e mbeturinave organike. - Npërmjet projektit për kompostim shtëpiak në bashkëpunim me ekonomitë familjare ku do të realizohet projekti do të sigurojmë parakushte për qytetarë për ndarje të mbetjeve organike përmes ofrimit të komposterit si infrastrukturë, zvogëlim i koston së deponimit të mbeturinave përmes zvogëlimit të sasisë së mbetjeve që shkojnë në deponi,

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

	profit ekonomik përmes prodhimit të plehut organik prej ndarjes së mbetjeve për kompostim për nevoja individuale dhe ngritje të vetëdijes së komunitetit për rëndësinë e trajtimit të mbetjeve si resurs për përfitim. 2. Blerja e Kontejnerëve me qëllim të rritjes së numrit të ekonomive familjare dhe bizneseve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave; - Përmes projektit “Blerja e Kontejnerëve dhe Shportave për Mbeturina” të financuar nga komuna e Drenasit, janë blerë 380 kontejnerë 120 dhe 240 litërsh. Këta kontejnerë i janë dorëzuar kompanisë “Pastrimi” e cila në bashkëpunim me zyrtarët komunal do të shpërndajë shportat me qëllim që çdo ekonomi familjare dhe biznes të ketë qasje në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. 3. Procesi i shpërndarjes së shportave dhe rritja e numrit të klientëve që ju ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave. - Ky proces në vazhdimësi është duke u realizuar dhe si rezultat i këtyre aktiviteteve në këtë vit, janë duke hyrë në sistem të menaxhimit të mbeturinave edhe shumë ekonomi familjare, Institucione (shkollat), e biznese. Për ta arritur qëllimin, jemi duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Inspektoriatit. Sa i përket mbulueshmërisë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave kemi mbulueshmërinë në 100% të territorit të Komunës së Drenas-it. 4. Projekti “Ndarja e Mbeturinave të Riciklueshme në Burim” - Komuna e Drenasit ka pranuar donacion nga GIZ-i – gjerman në vlerë prej 100 kontejnerëve 240 litërsh, me qëllim zgjerimin e zonave dhe rritjen e numrit të ekonomive familjare që kanë qasje në ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim. 5. Investimet në stacion transferin e mbeturinave; Në deponinë e transferit është siguruar makina - presa nga kompania “Pastrimi” ku si rezultat do të mundësohet paketimi (presimi) i mbeturinave të riciklueshme nga vetë kompania “Pastrimi”, e gjithë kjo do të ndikojë në zvogëlimin e sasisë së mbeturinave dhe koston e shpenzimeve në bartjen e tyre deri në deponin regjionale. Po ashtu këtë vit komuna e Drenasit ka shprehur gatishmëri për bashkëfinancim në kuadër të përfitimit të projektit “Rehabilitimi i Stacionit të Transferimit të Mbeturinave në komunën e Drenasit” i cili do të mbështetet nga “KRM Pastrimi”, GIZ dhe CMSR. 6. Procesi i identifikimit të deponive ilegale; Gjatë këtij viti është realizuar identifikimi i deponive ilegale për vitin 2019 nga zyrtari komunal për menaxhimin e mbeturinave dhe inspektori komunal mjedisor në bashkëpunim me GIZ-in. Gjatë këtij procesi është bërë identifikimi i 31 deponive ilegale
--	--

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

	në komunën e Drenasit nga 90 që ishin në vitin 2018. Prej gjithsej 31 deponive ilegale të identifikuara 11 prej tyre janë të vogla, 9 të mesme dhe 11 të mëdha. 7. Projekti për eliminimin e deponive ilegale; - Në kuadër të projektit për eliminimin e deponive janë duke u realizuar aktivitetet punuese për largimin e deponive ilegale edhe përgjatë vitit 2020 ku deri më tani janë larguar 13 deponi të mbeturinave. Pas largimit të mbeturinave në ato vende do të vendosen tabela informuese mbi ndalim hedhjen e mbeturinave në mënyrë jo adekuate. 8. Projekti për mirëmbajtjen e deponisë inerte në Llapushnik; - Në kuadër të këtij projekti mundësohet mirëmbajtja e deponisë inerte në Llapushnik e cila është e destinuar për hedhjen e mbeturinave ndërtimore.
Aktivitetet në realizimin e projekteve kapitale	Për realizimin e projekteve kapitale janë kryer këto aktivitete kryesore: • Hartimi i deklaratave të nevojës për projektet e DSHPE-së, • Hartimi i kërkesave për zotim të mjeteve , • Hartimi i projekteve ideore për secilin projekt, • Hartimi i paramasave dhe parallogaritjeve , • Caktimi i organeve për mbikëqyrjen e projekteve, • Faza e implementimit të projekteve, • Faza e pranimi teknik të projekteve. Gjatë këtij gjashtë muaji janë realizuar projektet një vjeçare dhe ato që janë me kontratë kornizë, të cilat po i paraqesim si më poshtë. • Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave në Komunën e Drenasit Në kuadër të këtij projekti është bërë rregullimi i rrethojës së varrezave, ky projekt është në procedurë të zhvillimit në prokurim dhe këtë vit do të bëhet rregullimi i varrezave në fshatrat: Tërdec (Lagja e Tahiraj), Tërstenik (Lagja Zhushi, Hoti) dhe Vasilevë. • Renovimi i rrugëve të asfaltuara- (kontratë kornizë), janë riparuar disa pjesë të rrugëve në qendër të qytetit në rrugët “Ilaz Kodra”, “Fehmi e Xhevë Lladrovci”, “Besim Mala” dhe në fshatrat, në rrugën “Sokol Elshani” në Drenas, Baicë, Likoshan , Sankoc lagja Janova. • Zgjerimi dhe mirëmbajtja e kamerave në komunën e Drenasit: ky projekt është në procedurë të zhvillimit në prokurim dhe është planifikuar si projekt kornizë që do të realizohet në territorin e Drenasit. • Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik: (kontratë kornizë), ky projekt është realizuar duke bërë realizuar në vazhdimësi, kryesisht kemi të bëjmë me mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

	• Bashkëfinancim i projekteve: ky projekt është në procedura të realizimit, kryesisht rreth menaxhimit të mbeturinave. • Blerja e kontejnerëve dhe shportave për mbeturina: ky projekt është realizuar duke bërë furnizimin e dy lloje të kontejnerëve dhe atë: 120 l dhe 240 l, dhe janë shpërndarë në ekonomitë familjare dhe biznese gjatë procesit të zgjerimit. • Shenjëzimi Vertikal dhe Horizontal i rrugëve (Kontratë Kornizë): Është realizuar projekti i shenjëzimit vertikal dhe horizontal në të gjitha vendet ku kemi pasur kërkesa si: shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në qendër të qytetit, parkingjeve, shenjëzimi vertikal për vendndalje të autobusëve, shenjëzimi horizontal në stacionin e autobusëve, kompletimi me shenjëzim vertikal tek rrugët ku atakohen me hekurudhën, shenjëzimi horizontal dhe vertikal i zebrave në rrugët në qendër të Drenasit, dhe vendbanime tjera ku ka qenë e nevojshme, sidomos në rrugët që janë në afërsi të shkollave. • Mirëmbajtja e rrugëve gjatë sezonës dimërore për vitin 2019- 2020. Projekti ka filluar sipas sezonës dimërore dhe ka përfunduar sipas kontratës. Në këtë projekt kanë qenë të përfshira për mirëmbajtje dhe pastrim nga bora rreth 530 km rrugë dhe 26,405 m², sipërfaqe me parkingje, Sheshe dhe trotuare. • Mirëmbajtja e rrugëve gjatë verës (projekt kornizë)- është nënshkruar kontrata me kompaninë publike KRM dhe është duke vazhduar realizimi me larje dhe fshirjet e rrugëve kryesore dhe atyre periferike të qendrës së qytetit të Drenasit në çdo javë, dhe në rrugët e qendrës së Komoranit. • Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike dhe gropave septike (kontratë kornizë): ky projekt është duke u implementuar në gjithë territorin e Komunës, në bazë të kërkesave të ardhura nga administratoret e fshatrave, dhe detyrës zyrtare që është e paraparë me ligj për mirëmbajtje të ambientit (kanalizimeve atmosferike, fekale dhe gropave septike), të cilat po kryhen në mënyrën më të mirë të mundshme, duke zhblokuar kanalizimet të cilat me vite kanë qenë të pazgjidhura. Në këtë rast janë bërë deblokime të kanalizime me gypa duke filluar nga ata Ø200, 250, 315 dhe 400 (mm), dhe pastrimi i gropave septike dhe kanalizimit atmosferik. • Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të katërt me zhavor- Është duke u implementuar në bazë të kërkesave të administratorëve të fshatrave, dhe janë duke realizuar të gjitha ato kërkesa që janë të arsyeshme. • Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimi i qytetit të Drenasi (kontratë kornizë): Ky projekt është implementuar sipas paramasës dhe parallogarisë dhe njëherit është duke vazhduar. • Projekti i renovimit të objektit të Zjarrfikëseve- ky projekt është procedura të zhvillimit në prokurim . • Projekti i eliminimit të deponive ilegale, ky projekt është duke u implemtuar në dy faza dhe janë duke u eliminuar deponit e egra dhe deri me tani janë larguar 13 deponi të mbeturinave, po ashtu projekti është në vazhdimësi.
--	--

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

	• Projekti për Intervenimet Emergjente: (kontratë kornizë), Ky projekt është nënshkruar kontrata dhe ka filluar implementimi në terën sipas kërkesave të adresuar nga qytetarët. Po ashtu duhet të theksohet që zyrtaret e DSHPE-së për rastet emergjente dhe në projektet tjera(si ai i mirëmbajtës se rrugëve gjatë dimrit dhe projektet tjera), • Projekti për Shërbimet e varrimit për qytetarët e Komunës së Drenasit: ky projekt është duke u implementuar në bazë të shënimeve të sjella nga Bashkësia Islame për shërbimet e kryera. • Nga aspekti i Eficiencës së Energjisë është formuar grupi punues për përgatitje për aplikim për projekte të fondit eficient. Në kuadër të këtij projekti grupi punues ka aplikuar me shtatë(7) projekte të cilat janë në listën e Planit të Veprimit për Eficiencë të Energjisë.
Kryetari i Komitetit të Administrimit të Bashkisë	Për vitin 2020 DSHPE-ja ka planifikuar buxhetin prej 9,000 € për subvencione dhe transfere, ku këto mjete kryesisht do të shpenzohen për t'iu dalë ndihmë familjarëve të cilëve u janë shkaktuar dëmet nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (zjarre, vërshime, erëra. Po ashtu nga komisioni komunal i caktuar nga zyra e kryetarit kanë bërë vlerësimet e dëmeve dhe do të vazhdohet me procedura.
	▪ Gjatë periudhës gjashtë mujore në adresë të DSHPE-së janë pranuar këto kërkesa: - 470 – kërkesa të ndryshme siç janë: - kërkesa për mirëmbajtje të kanalizimit dhe gropave septike, të cilat janë realizuar dhe trajtuar të gjitha. - kërkesa për shenjëzim horizontal dhe vertikal të komunikacionit, - kërkesa për zhavor për rrugët e rendit të IV, - kërkesa për renovimin e gropave të asfaltit , - kërkesa për zgjerim të ndriçimit publik, - kërkesa për parkingje të rezervuara, - kërkesa për pastrimin e deponive ilegale të mbeturinave, - kërkesa për rregullimin e rrethojave për varreza, - kërkesa për kompensim të dëmeve nga FNFT dhe - kërkesa të natyrave tjera të ndryshme. - Kërkesë për furnizim me ujë higjienik • Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar dhe sipas detyrës zyrtare ato që kanë qenë të realizueshme kanë përfunduar, ndërsa pjesa tjetër ose është refuzuar ose është ende në proces për shkak të mungesës së buxhetit, mirëpo u është kthyer përgjigje palëve. Punëtorët e DSHPE-janë duke punuar jashtë orarit të punës, prandaj duhet gjetur mundësin e kompensimit për këtë orët jashtë orarit.
Menaxhimi i Stacionit të Autobusëve dhe	DSHPE-ja në bazë të Vendimit 01 Nr. 344-8563 prej dt. 16/02/2016, ka në Menaxhim Stacionin e Autobusëve me objekte përcjellëse në Glllogoc, deri sa të definohet statusi i tij. Paga e tarifave në emër të kryerjes së shërbimeve për peronizim, provizion nga Operatorët Ekonomik bëhen në lartësi të tarifës së shërbimeve që janë përcaktuar nga Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë për Stacionet e Autobusëve të kategorisë së dytë,

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

parkingjeve publike	mirëpo këtë vit për shkak të pandemisë janë respektuar vendimet e marra nga niveli qendror. Në fushën e menaxhimit të parkingjeve publike, janë bërë shenjëzimet e vertikale dhe horizontale të parkingjeve të rezervuara dhe janë duke u lëshuar leje për shfrytëzim një vjeçar.								
Shërbimi i zjarrefikësve	DSHPE-ja në bashkëpunim të plotë me Njësinë Profesionale të Zjarrefikësve dhe Shpëtimit (NJPZSH), Rastet emergjente: gjatë gjashtë muajve të parë në territorin e komunës së Drenasit, ka pasur situata emergjente të cilat janë trajtuar dhe më theks të veçantë vërshimet, rastet e zjarreve fushore dhe malore të cilat shumica prej tyre, dyshohet që janë shkaktuar si pasojë e pakujdesisë nga faktori njeri, po ashtu zjarret në objektet e banimit dhe objekte të tjera. Për të gjitha rastet janë marrë masat për reagim të shpejt në parandalimin dhe zvogëlimin e dëmeve të shkaktuara. Pjesëmarrja ka qenë aktive në të gjitha rastet emergjente duke përfshirë të gjitha rastet e FNFT. Intervenimet e NJPZSH-së ishin si në vijim: <table> <tr> <td>1) Shuarje të zjarreve</td><td>210</td></tr> <tr> <td>2) Shërbime teknike(furnizim me ujë)</td><td>80</td></tr> <tr> <td>3) Vërshime</td><td>1</td></tr> <tr> <td>4) Intervenime teknike</td><td>22</td></tr> </table>	1) Shuarje të zjarreve	210	2) Shërbime teknike(furnizim me ujë)	80	3) Vërshime	1	4) Intervenime teknike	22
1) Shuarje të zjarreve	210								
2) Shërbime teknike(furnizim me ujë)	80								
3) Vërshime	1								
4) Intervenime teknike	22								
Takimet zyrtare	• Takim me organet kompetente që mundë të kontribuojnë, me qëllim të bashkëpunimit në mbarëvajtjen e punëve në Drejtorinë e Shërbimeve Publike • Takime me përfaqësuesit e organizatës së Giz-it (për çështje të komposterëve), • Takim me Asociacionin e Komunave të Kosovës,(takime online, në formë virtuale) • Takim me agjencinë e Emergjencave-AME, (takime online, në formë virtuale) • Takim me strukturat e KEDS-it, • Takime me administratorët e fshatrave, me biznese, me qytetar rreth menaxhimit të mbeturinave, ndarjes dhe zgjerimit të shërbimit, furnizim me ujë pijshëm.								
Vizioni i DSHPE-së:	Vizioni i kësaj Drejtorie është që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që janë të parapara me Statutin e Komunës, Ligjin për Qeverisje Lokale, dhe planin e punës së DSHPE-së.								
Misioni DSHPE-së	Misioni i DSHPE-së është që të rritë cilësinë e shërbimeve publike, mirëmbajtjen infrastrukturës në përgjithësi, dhe rritjen e mirëbesimit të qytetarit në kryerjen e këtyre shërbimeve.								
Qëllimi i DSHPE-së:	Është që të rris standardin në mirëmbajtjen e infrastrukturës së shërbimeve publike, duke i realizuar të gjitha projektet e mirëmbajtjes që përfshijnë: Mirëmbajtjen e rrugëve të asfaltuara dhe të rendit të-IV, trotuareve, mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik, menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësin për ujë të pijes, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e parqeve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra, shërbimi i transportit publik me autobus dhe								

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

	autotaxi, mirëmbajtën e parkingjeve, mirëmbajtën e rrugëve gjatë sezonës së verës dhe dimrit, shenjëzimin horizontal dhe vertikal të rrugëve, menaxhimin dhe trajtimin e rasteve emergjente që shkaktohen nga e fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, shërbimin e varrimit për qytetarë.
--	--

2.11. INFRASTRUKTURA PUBLIKE

Drejtoria për Infrastrukturë Lokale, detyrat e punës i ka kryer duke u bazuar në planprogramin e punës, duke u mbështetur në Ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të detyrave e obligimeve të përcaktuara me Statutin e Komunës së Drenasit. Drejtoria për Infrastrukturë Lokale është angazhuar në projektet si: rregullimin e kanalizimit të ujërave të zeza, ndërtimin e ujësjellësve, trotuareve, ndriçimit publik, rregullimi dhe pastrimi i lumenjve, projekti i kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza si dhe projekte tjera.

Aktivitetet e zhvilluara nga DIP:

Përpilimi i kërkesave të investimeve kapitale, deklarata e nevojave për publikimin e projekteve kapitale, specifikacionet teknike për projektet e DIP.

Aplikimi në ministri të ndryshme për përfitimin e projekteve kapitale në interes të Komunës.

Përpilimi i njoftimeve për palët në përgjigjet e kërkesave.

Përpilimi dhe përgaditja për zyre të prokurimit rreth 20 projekte

Hapja dhe vlersimi i ofertave për tendere

Mbikqyrja dhe menaxhimi i kontratave të investimeve kapitale.

Pranimi teknik i projekteve të realizuara në teren

Takime me ministri të ndryshme rreth projekteve kapitale dhe përpilimi i marrëveshjeve të memorandumëve të mirëkuptimit.

Puna në komisione të ndryshme të caktuara nga Kryetari i Komunës dhe Drejtorët

Plotësimi i formularëve për performancë komunale

Përpilimi i buxhetit për investime kapitale korniza buxhetore 2021-2022-2023.

Aktivitetet e mbikqyrjes së punimeve nga puntorët e drejtorisë së Infrastrukturës Publike.

Punët me palë.

Përpilimi i rishiqimit të buxhetit dhe propozimi me bartje të buxhetit për vitin 2019

Gjatë periudhës Janar - Qershor janë dërguar gjithësej 430 kërkesa ku 350 prej tyre janë kthyer përgjigjet ndërsa 80 prej tyre janë në proces.

III. Projektet me ministri të ndryshme dhe zhvillimi i aktiviteteve

1. Ndërtimi i Kolektorëve të Ujërave të zeza me MZHR aneks marrëveshja në vlerë prej 100,000.00€ + 25,000.00€(Komuna e Skenderajt) project i fazës së parë në fazën përfundimtare.



RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

2. Ndërtimi i Kolektorëve në Komunën e Drenasit nga Grandi i Përformances në vlerë 287,000.00.00€ dhe planifikimi komunal 680,000.00€ me gjatësi prej - L= 21,000.00 m'
3. -LOT- 1 --Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit, - Zona e Komaranit në total L=9,435.00 m.
4. -LOT- 3 - Ndërtimi i kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit",- Zona e Arllatit. Ndërsa, projekti ka në total L=11,000.00 m.
5. Ndërtimi i kanalizimit në Komunën e Drenasit- Kanë filluar punimet në ndërtimin e kanalizimit të ujërave të zeza në fazë e parë me gjatësi L=35,000.00 m',
6. Asfaltimi i rrugës Tërdec - Vuqak në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës në vlerë prej 450,000.00€ (projekt tre vjeçar) janë duke u zvilluar punimet në terren.
7. Ndërtimi i rrugës Gradicë – Zhilivodë, projekt financiar nga MIT punët janë duke vazhduar krahas buxhetit.
8. Ndërtimi i rrugës tranzit Kroi i Mbretit – Feronikeli-Drenas janë duke u zvilluar punimet.
9. Ndërtimi i rrugës së re Kroni i Mbretit - Liqeni i Vasilevës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit në vlerë financiare 600,000.00€. Punimet vazhdojnë deri në vitin 2020.
10. Ndërtimi i rrugës Bregut të Qyqavicës në bashkëpunim ndërkomunal me Komunën e Skenderajit në vlerë 187,000.00€.

Vështirësitë rreth punëve në zyre dhe terren

Mungesa e stafit në DIP, ndërsa, angazhimi i punëtorëve në projekte është tejte i madh.

Problemet në terren janë të natyrave të ndryshme, si duke u nisur nga pengesat e banorëve në lidhje me kontestet pronësore si dhe problemet tjera me operatorët ekonomik.

Sfidë kryesore mbetet çmimi ekonomikisht më i lirë e cila e ulë çmimin e cilësisë së punëve dhe kualitetin e punimeve.

Alokimi i buxhetit është bërë në muajin Qershor, për shkak të pandemisë.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

Zhvillimi i aktiviteteve të projekteve kapitale në formën tabelare të financuar nga buxheti i komunës në vlerë 3,014,490.0 € grande qeveritare në vlerë financiare 2,519,361.00 €, ndërsa, të hyra vetanke 495,129.00 €. 5% e vlerës së paraparë janë ndarë për pandeminë Covid-19.

Planifikimi i buxhetit për projektet kapitale- 2020					
	DREJTORIA PËR INFRASTRUKTURË	Te planifikuara			
Nr.	Shpenzimet Kapitale	2020	10 BKK	21 THV	Zhvillimi i Projektit
1	Rregullimi i shtratit të lumit Drenica dhe Vërbica	100,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
2	Ndërtim i kolektorëve për grumbullimin e ujërave te zeza ne Komune Drenas	420,000.00 €	420,000.00 €		Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit i ndare ne tri lote
3	Rregullimi i Infrastrukturës, trotoareve dhe ndriçim publik Komunën e Drenasit	233,291.00 €	233,291.00 €		Është dorëzuar ne zyrën e prokurimit për publik
4	Ndërtimi I infrastrukturës (Asfaltimi dhe Kubëzimi)Drenas I,I,III,IV	150,000.00 €	150,000.00 €		Do te dorëzohen ne muajin Qershor
5	Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit " Fehmi dhe Xhevë Lladrovci Drenas	10,000.00 €	10,000.00 €		Është bere rishikimi i këtij projekti me rishikim te buxhetit
6	Infrastruktura ne Komoran I,II,III,IV	50,000.00 €	50,000.00 €		Janë duke u zhvilluar punimet ne Rrjetin e Kanalizimit Fekal
7	Ndërtimi i Urave dhe Tombinave dhe mureve Mbrojtëse	100,000.00 €	100,000.00 €		Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
8	Rehabilitimi dhe Rikonstruktimi i Rrugëve te Asfaltuara ne Drenas	200,000.00 €	200,000.00 €		Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
9	Rehabilitimi dhe Rikonstruktimi i Rrjetit te	30,129.00 €	0.00 €	30,129.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

	Kanalizimeve ne Komunën e Drenasit				te zyrës se prokurimit.
10	Asfaltimi i rrugës në fshatin Gllanasellë Godanc	30,000.00 €	15,000.00 €	15,000.00 €	Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
11	Asfaltimi i rrugës në Fshatin Tërstenik I,II dhe Gllobar	80,000.00 €	50,000.00 €	30,000.00 €	Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
12	Asfaltimi i rrugës në fshatin Poklek i Vjetër ,Poklek i Ri, Vasilevë	30,000.00 €		30,000.00 €	Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
13	Infrastruktura në Fshatin Abri e Epërme ,Tërdec	60,000.00 €	60,000.00 €		Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
14	Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshec ,Çikatovën e Vjetër.	50,000.00 €	50,000.00 €		Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
15	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Baicë, Krajkovë, Damanek Shtrubullova	70,000.00 €	70,000.00 €		Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
16	Ndërtimi i Infrastrukturës ne fshatin Nekoc, Kizharekë	50,000.00 €	50,000.00 €		Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
17	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Gradicë ,Likoshan	50,000.00 €	50,000.00 €		Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
18	Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë si dhe Bytyqi	50,000.00 €	50,000.00 €		Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

					tjera përcjellëse
19	Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulet	30,000.00 €	30,000.00 €		Në fazën e zhvillimit të projektit hartimit të tij dhe fazave tjera përcjellëse
20	Asfaltimi i rrugës në fshatin Tërdec - Vuçak	5,000.00 €		5,000.00 €	Ky projekt është duke u financuar nga MIT
21	Hartimi I projektit për fizibilitetin e ngrohjes qendrore	5,000.00 €		5,000.00 €	Nuk ka aktivitet
21	Asfaltimi i rrugës në Shtuticë ,Vërboc ,Polluzhë	45,000.00 €	45,000.00 €		Në fazën e zhvillimit të projektit hartimit të tij dhe fazave tjera përcjellëse
22	Asfaltimi i rrugës në fshatin Llapushnik, Potërk - Vukovc	30,000.00 €		30,000.00 €	Në fazën e tenderimit të projektit
23	Asfaltimi i rrugës në fshatin Zabel i Ulët dhe I Epërm Korroticë e ulet dhe e Epërme	50,000.00 €	50,000.00 €		Në fazën e zhvillimit të projektit hartimit të tij dhe fazave tjera përcjellëse
24	Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Drenas	131,070.00 €	131,070.00 €		Në fazën e zhvillimit të projektit hartimit të tij dhe fazave tjera përcjellëse
26	Bashkëfinancim projekte me donator të jashtëm	180,000.00 €	180,000.00 €		Ne proces të zhvillimit të projekteve me donator të jashtëm
27	Mbikëqyrja e projekteve kapitale në KK Drenas	50,000.00 €	50,000.00 €		Është bërë rishikimi i këtij projekti me rishikim të buxhetit
28	Hartimi i projekteve zbatuese për nevoja e Komunës	40,000.00 €	40,000.00 €		Nuk ka aktivitet
29	Rregullimi i deponive mbeturinave inerte	10,000.00 €		10,000.00 €	Nuk ka aktivitet

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISIES LOKALE

30	Rregullimi i vend-ndaljeve dhe mbulimi i tyre	10,000.00 €		10,000.00 €	Ky projekt është duke u realizuar me drejtorin e Shërbimeve Publike.
31	Hapja e kanaleve kullues përgjatë rrugëve ne Komunën e Drenasit	10,000.00 €		10,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
32	Kanalizimi ujërave te zeza dhe atmosferike ne Drenasin I,II,III,IV	200,000.00 €	200,000.00 €		Në fazën e zhvillimit te projektit hartimit te tije dhe fazave tjera përcjellëse
33	Kanalizimi i ujërave te zeza ne fshatin Komoran I,II,III,IV	30,000.00 €		30,000.00 €	Janë duke u zhvilluar punimet ne Rrjetin e Kanalizimit Fekal
34	Kanalizimi i ujërave te zeza ne fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë dhe Bytyqi	40,000.00 €		40,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
35	Kanalizimi ujërave te zeza ne Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Fushticë e Ulet	35,000.00 €	20,000.00 €	15,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
36	Kanalizimi i ujërave te zeza ne Tërstenik I, II dhe Gllobar	50,000.00 €		50,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
37	Kanalizimi ujërave te zeza ne Korroticë e ulet, Korroticë e Epërme Poklek i Vjetër dhe i Ri	30,000.00 €	30,000.00 €		Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
38	Kanalizimi i ujërave te fshatit Dobroshec, Çikatovë te Vjetër	20,000.00 €		20,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
39	Kanalizimi i ujërave te zeza ne fshatin Abri e Epërme ,Tërdec	40,000.00 €		40,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
40	Kanalizimi i ujërave te zeza ne fshatin Gllanasellë ,Godanc	20,000.00 €		20,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISSES LOKALE

41	Kanalizimi i ujërave te zeza ne fshatin Gradicë, Likoshan	20,000.00 €		20,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
42	Kanalizimi i ujërave te zeza në fshatin Llapushnik, Paterk, Vukoc.	20,000.00 €	0.00 €	20,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
43	Kanalizimi i ujërave te zeza ne fshatin Nekoc ,Kizharekë	40,000.00 €		40,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
44	Kanalizimi i ujërave te zeza ne Fshatin Shtuticë, Vërboc	30,000.00 €		30,000.00 €	Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
45	Asfaltimi i Rrugës Llapushnik Berishë	5,000.00 €		5,000.00 €	Për shkak te kostos se madhe te projektit kërkohet investim nga Ministria e Infrastrukturës.
46	Kanalizimi i ujërave te zeza ne fshatin Baicë, Krajkovë, Damanek dhe Shtrubullovë	40,000.00 €	40,000.00 €		Projekti është në poces te vlerësimit te zyrës se prokurimit.
totali:		2,979,490.00 €	2,424,361.00 €	555,129.00 €	

2.12. DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Drenasit gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2020 (01.01.2020-30.06.2020) në kuadër të fushëveprimtarisë ka ofruar këto punë/shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës, në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet tjera nënligjore, rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal i Drenasit, dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2020.

Numri i bizneseve të regjistruara nga data 01.01.2020 deri me datën 30.06.2020 është 88 biznese të reja, krahasuar me vitin paraprak të njëjtës periudhë që ishin regjistruar 110 biznese ose shprehur në përqindje **25.00%** më pak se në vitin e kaluar, të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë 142 punëtorë.

Bizneset fillestare brenda ditës pajisen me çertifikatën e biznesit me Numër Unifikes të biznesit, si dhe jepen konsulenca të ndryshme të kësaj natyre, për ta krijuar një ambient sa ma të volitshëm për

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

regjistrim dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Numri i bizneseve në këtë periudhë është si vijon :

I. Tabela e klasifikimit të bizneseve të punësuarve regjistruara në periudhën: 01.01.2020 – 30.06.2020

Klasifikimi sipas madhësisë	Numri i punëtorëve	Numri i bizneseve	Përqindja në total
Të vogla	1-5	53	60.00%
Të mesme	5 – 60 (Sh.p.k.)	35	40.00%
Të mëdha	60 - e më tepër	-	-
Gjithsejtë:		88	100.00%

II. Nga tabela e paraqitur më lartë vërehet se të gjitha bizneset e regjistruara në periudhën 01.01.2020 – 30.06.2020 i takojnë ekskluzivisht kategorisë së bizneseve të vogla (60.00%).

Nr .	Bizneset kryesisht janë të përqendruara në këto veprimtari:	Shpërndarja e bizn. sipas veprimtarive	Përqindja
1.	Tregëti	16	18.00%
2.	Transport	9	10.00%
3.	Ndërtimtari	27	30.00%
4.	Hoteleri	14	16.00%
5.	Bujqësia	11	13.00%
6.	Shëndetësi	5	6.00%
7.	Industri- zëjtari prodhuese	-	-
8.	Arsim	6	7.00%
	Gjithsejtë:	88	100.00 %

III. Bizneset e regjistruara në Komunën e Drenasit sipas llojit të pronësisë në periudhën .01.2020 – 30.06.2020

Nr.	Lloji i pronësisë	Numri i bizneseve	Përqindja
1	Biznes individual	53	60.00%
2	Ortakëri e përgjithshme	/	
3	Ortakëri e kufizuar	/	
4	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	35	40.00%
5	Shoqëri Aksionare	/	
6	Ndërmarrje në pronësi të huaj	/	
7	Ndërmarrje publike	/	

RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

8	Kooperativë bujqësore	/	
	TOTALI:	88	100.00%

Të dhënat e QKB të paraqitura në tabelën e mësipërme ofrojnë informata në lidhje me strukturën pronësore të bizneseve të regjistruara me 01.01.2020 – 30.06.2020 në Komunën e Drenasit. Bizneset individuale gjatë kësaj periudhe ekskluzivisht dominojnë strukturën pronësore bizneset individuale me 60.00% dhe 40.00% Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar, regjistrimi i tipit të biznesit SHPK.

Gjatë periudhës 01.01.2020 – 30.06.2020, në vijim me kërkesën e pronarëve të bizneseve janë regjistruar gjithsejtë: 65 ndryshime të bizneseve ekzistuese ,në periudhën paraprake të vitit të kaluar bizneset që patën ndryshime ishte 80 biznese ose 14.00% ma pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe sipas muajve dukën kështu:

IV. Ndryshime në biznes sipas periudhës: 01.01.2020 – 30.06.2020;


Nr.	Muajt e vitit	I	II	III	IV	V	VI
1.	Ndryshimet në biznese	7	17	15	12	5	9

V. Punë/ shërbime tjera, gjatë periudhës: 01.01.2020 – 30.06.2020;

Nr.	Shërbimi/Lënda	Totali:
1	Shuarje të bizneseve	6
	Çertifikata të reja për biznese fillestare	88
	Çertifikata të ripërtërira	161
	Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznese.	19
2	Vërtetime që nuk posedojnë obligime të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznese.	7
3	Pagesa të Taksës për Biznes sipas faturimit.	54.500,00€

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofron kjo drejtori kanë marrë pjesë stafi sipas kërkesës në:

- Pjesëmarrje në punëtori: “Rrjeti Rajonal për Ngritje të Kapaciteteve” e organizuar nga Asociacioni i Komune të Kosovar.
- Pjesëmarrja në trajnimin; “ Leadershipi dhe dhe Menaxhimi i Administratës Lokale” të organizuar nga IKAP.



RAPORTI I PUNËS JAMAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

- Pjesëmarrja në seminarin e organizuar në mënyrë virtuale me temë: “ Analiza për investime Kapitale e realizuar sipas rajoneve Zhvillimore të vitit 2019 “ e organizuar Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale(KLGI) dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.
- U realizuan takime me përfaqësuesit institucioneve të nivelit qendror, organizatave vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të arritjen se marrëveshjes/bashkëpunimit për të gjetur mundësin e përkrahjes/financimit e projekteve zhvillimore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës së Drenasit dhe sektorit privat/ bizneseve të cilat operojnë në territorin e komunës së Drenasit.
- Takim me përfaqësuesit nga MTI – Agresioni për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, tema: “Bashkëpunimi i rregullt dhe koordinimi rreth aktiviteteve për promovimin e investimeve në Komunën e Drenasit.
- Takim me përfaqësuesit e OSBE-së, tema: Gjetja e mundësia e bashkëpunimit/financim të aktiviteteve të planifikuara komunale të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal.
- Takim me përfaqësuesit e Organizatës HELP, gjetja e mundësive të bashkëpunimit për të nxituar zhvillimin ekonomik të komunës së Drenasit, përkrahja e projekteve të bizneseve, dhe mundësia e përkrahjes se START-UP-ve.
- Takim me përfaqësuesit e EÖMEN FOR WOMEM, mundësia e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të tyre me Komunën e Drenasit.
- Takim me udhëheqësen e Agjencisë për Zhvillim Rajonal –Qendër , me temë diskutimi skema e investimeve kapitale të lansuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, si dhe shpalosëm planet dhe mundësin e rritjes së bashkëpunimit.
- Janë realizuar takime me përfaqësuesit e bizneseve dhe të diskutoj për sfidat, pengesat, mundësitë dhe planet zhvillimore.
- Janë realizuar takime me përfaqësueset e shoqatave dhe organizatave joqeveritare, me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në nivelin lokal, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e jetës ekonomike, sociale të Komunës së Drenasit.

Arritja e marrëveshjeve/bashkëpunimeve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të NMV


- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën HELP
- ✓ Marrëveshje bashkëpunimi me organizatën WOMEN FOR WOMEN

Projektet të cilat janë duke u implementuar:

- “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në Kosovë”, projekt bashkëpunues mes Komunës së Drenasit dhe organizatës HELP

Informimi me kohë në platformën online dhe informim në zyre të drejtorisë lidhur me gjetjen dhe mundësin e aplikimit në grande, projekte dhe subvencione adresuar: sektor privat/bizneseve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit si:

- Thirrje për projekte të vogla nga Ambasada gjermane;



RAPORTI I PUNËS JANAR-QERSHOR 2020 I KRYETARIT DHE QEVERISJES LOKALE

- Thirrje për aplikim në projektin “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në Kosovë”, projekt bashkëpunues mes komunës së Drenasit dhe organizatës HELP.
- Thirrje për aplikim “Mbështetja për përshpejtimin e biznesit (Business Acceleration Support) nga WEE (Women Energy Support).
- Thirrje për aplikim për gande në - Skemen e Granteve „Programi i Zhvillimit Rajonal të Balansuar” PZHRB 2020, për propozimet për start-up dhe biznese ekzistuese, të shpallur nga MZHR-ja.
- Thirrje për aplikim në projektin “Përgjigje e shpejtë ndaj pandemisë COVID-19-mbështetje e grupeve më të cenushme të grave” nga Forumi Ekonomik i Grave i koordinuar nga Instituti Riinvest.

Zhvillimi dhe promovimi i turizmit:

- Me qëllim të mundësisë për promovim dhe zhvillim të turizmit të komunës së Drenasit është duke u bërë identifikimi i monumenteve historike në bashkëpunim me Drejtorin e Kulturës.

Si shkak i gjendjes pandemisë COVID-19 , shumë procese/projekte kanë mbetur pa u implementuar gjatë periudhës së parë të këtij viti (01.01.2020-30.06.2020).

KRYETARI I KOMUNËS

RAMIZ LLADROVCI

